SHTOJCË

STACIONI I DYTË I FJALËS SË NJËZET

Një Shkreptimë e mrekullisë së Kur'anit e cila shndrit mbi mrekullitë e profetëve

Vëreji me kujdes dy pyetjet dhe dy përgjigjjet në fund.

بِسْمِ اللّهِ الرَّحْمنِ الرَّحِيمِ

وَلاَ رَطْبٍ وَلاَ يَابِسٍ اِلاَّ فِى كِتَابٍ مُبِينٍ

Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Nuk ka asgjë të njomë ose të thatë që të mos jetë shkruar në një libër të Qartë."[234]

Katërmbëdhjetë vjet më parë[235] në komentimin tim Kur'anor të titulluar *"Isharatul I'xhaz"* -Shenjat e mrekullisë-, unë shkrova studimin në arabisht rreth një misteri të këtij vërseti. Tani dy nga vëllezërit e mi, dëshirat e të cilëve janë të rëndësishme në këndvështrimin tim, më kanë kërkuar një lloj shpjegimi të asaj pune studimore në turqisht dhe kështu duke u mbështetur tek ndihma e Zotit të Gjithëfuqishëm dhe në shkëlqimin e Kur'anit, unë them këtë:

Sipas një interpretimi, *'Libri i Qartë'* ose *'Regjistri*', është Kur'ani. Ky vërset pohon se gjithçka, e njomë dhe e thatë, gjendet brenda tij, a është kështu? Po, çdo gjë gjendet në të, por gjithkush nuk mund ta shikojë gjithçkanë në të, sepse ato ndodhen në nivele të ndryshme. Ndonjëherë gjenden farërat e gjësë ose bërthamat e saj, ndonjëherë përmbledhjet, ndonjëherë parimet dhe ndonjëherë shenjat; ato gjenden ose qartë, ose në mënyrë të nënkuptuar në heshtje, ose në mënyrë simbolike, ose në mënyrë të paqartë, të fshehur, ose si një kujtues.

---

[234] Kur'an, 6: 59

[235] Synon vitin e parë të Luftës së Parë Botërore. (përkthyesi)

Atëherë, Kur'ani i Gjithurtë i shpreh qëllimet e tij brenda stileve dhe mënyrave të elokuencës së tij sipas nevojës, dhe në mënyrë të përshtatshme e në lidhje me kërkesat e pozitës. Për shembull, gjërat si aeroplanët, elektriciteti, hekurudhat, dhe telegrafi dhe gjëra të ngjashme me këto, kanë ardhur në ekzistencë dhe janë vlerësuar si çudira të shkencës dhe të teknologjisë si rezultat i përparimit të njeriut, lidhur me shkencën dhe industrinë, dhe kanë marrë një pozitë më të lartë në jetën materiale të njerëzimit.

Sigurisht, Kur'ani i gjithurtë, i cili i adresohet gjithë njerëzimit, nuk i neglizhon e nuk i lë pas dore këto. Në të vërtetë, ai nuk i ka neglizhuar ato; ai i tregon në ***"Dy aspekte".***

Aspekti i parë: Në formën e mrekullive të profetëve...

Aspekti i dytë është ky: Ai i tregon ato në formën e disa ngjarjeve historike. Për shembull:

قُتِلَ اَصْحَابُ الْاُخْدُودِ ۞ النَّارِ ذَاتِ الْوَقُودِ ۞ اِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ ۞ وَهُمْ عَلَى مَا يَفْعَلُونَ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ۞ وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ اِلاَّ اَنْ يُؤْمِنُوا بِاللّٰهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ۞

[236] Kështu edhe: فِى الْفُلْكِ الْمَشْحُونِ .. وَخَلَقْنَا لَهُمْ مِنْ مِثْلِهِ مَا يَرْكَبُونَ

"Të mallkuar qenë populli i Hendekut" "Të zjarrit të furnizuar (pa masë) me lëndë djegëse! "Kur ata qëndruan pranë tij (zjarrit)" "Dhe ata dëshmuan çfarë ata po bënin kundër besimtarëve (dukę i djegur ata)." "Ata nuk kishin asgjë kundër tyre, veçse ata besuan në All-llahun, të Gjithëfuqishmin, Zotëruesin e denjë për të gjitha lavdërimet!"[237] Gjithashtu, në barkën (anijen) e ngarkuar rëndë të (Nuhut a. s.)." Dhe Ne kemi krijuar po si ajo për ta, të cilat i ngasin e udhëtojnë."[238]

Ashtu siç aludojnë këto vërsete për trenin e hekurudhat. Po ashtu vërsetet e mëposhtme aludojnë për elektricitetin, si dhe tregojnë shumë drita e mistere:

---

[236] Kjo fjali aludon se ajo që e lidhi botën e Islamit dhe e vendosi atë në robëri është treni, dhe me të mohuesit i mundën muslimanët (Autori).

[237] Kur'an, 85: 4-8

[238] Kur'an, 36: 41-42

اَللّٰهُ نُورُ السَّموَاتِ وَالْاَرْضِ مَثَلُ نُورِهِ كَمِشْكَاةٍ فِيهَا مِصْبَاحٌ اَلْمِصْبَاحُ فِى زُجَاجَةٍ اَلزُّجَاجَةُ كَاَنَّهَا كَوْكَبٌ دُرِّىٌّ يُوقَدُ مِنْ شَجَرَةٍ مُبَارَكَةٍ زَيْتُونَةٍ

"All-llahu është Drita e qiejve dhe e tokës. Shembulli i Dritës së Tij është si të kishim një qoshe të errët dhe në të një llambë, llamba e futur në një kupë qelqi, kupa e qelqit si të ishte yll që shkëlqen, e ndezur nga një pemë e bekuar, nga ulliri, as nga lindja, as nga perëndimi, vaji i të cilit digjet vetvetiu edhe pse nuk e ka prekur zjarri fare. Dritë përmbi dritë![239]

لاَ شَرْقِيَّةٍ وَلاَ غَرْبِيَّةٍ يَكَادُ زَيْتُهَا يُضِيءُ وَلَوْ لَمْ تَمْسَسْهُ نَارٌ نُورٌ عَلَى نُورٍ يَهْدِى اللّٰهُ لِنُورِهِ مَنْ يَشَاءُ

All-llahu udhëzon drejt Dritës së Tij atë që do Ai. Dhe All-llahu sjell shembuj e përngjasime për njerëzimin dhe All-llahu është për çdo gjë i Gjithëditur."[240]

Meqenëse shumë njerëz e kanë preokupuar vetveten me këtë llojin e dytë, dhe kanë nevojë për shumë vëmendje e sqarim, dhe meqenëse ata janë shumë, për tani ne do të mjaftohemi me këto vërsete që aludojnë për hekurudhat dhe elektricitetin dhe nuk do ta hapim atë derë.

Sa për llojin e parë, ai i tregon ato në formën e mrekullive të profetëve. Dhe ne do të përmendim disa prej këtij lloji nëpërmjet shembullit.

* * *

[239] Shënimi i vërsetit En-Nur (Drita) Fjalia

يَكَادُ زَيْتُهَا يُضِيءُ وَلَوْ لَمْ تَمْسَسْهُ نَارٌ نُورٌ عَلَى نُورٍ

"Vaji i të cilit digjet vetvetiu edhe pse nuk e ka prekur zjarri fare: Dritë përmbi Dritë! E ndriçon atë aluzion.

[240] Kur'an, 24: 35

Parathënie

Kur'ani i gjithurtë shpjegon se profetët, paqja dhe bekimet e Zotit xh.sh. qofshin mbi ta, u dërguan në komunitetet njerëzore si udhërrëfyes e si pararojë lidhur me përparimin e tyre shpirtëror, dhe njëkohësisht Kur'ani shpjegon se Zoti xh.sh. vendosi në dorën e secilit prej tyre disa mrekulli materiale dhe i bëri ata profesorët e Mjeshtrit kryesorë lidhur me progresin material të njerëzimit. Ai i urdhëron njerëzit që t'i ndjekin ata në mënyrë absolute. Kështu, ashtu si duke folur për plotësimet shpirtërore dhe morale të profetëve, ai i inkurajon njerëzit që të përfitojnë prej tyre; gjithashtu në diskutimin e mrekullive të tyre ai është duke bërë aluzione nxitjeje për të arritur gjëra të ngjashme me to dhe për t'i imituar ato.

Madje mund të thuhet se arritjet shpirtërore e morale, gjithashtu edhe arritjet materiale dhe çudirat, iu dhanë së pari njerëzimit si dhunti nga dora e mrekullive.

Kështu, ajo që i dha njerëzimit në fillim dhuntinë e anijes, e cila ishte një mrekulli e Hazreti Nuhut a.s. dhe dhuntinë e orës, e cila ishte një mrekulli e Hazreti Jusufit a.s., ishte dora e mrekullive. Është një tregues i hollë për këtë të vërtetë që shumica e artizanëve, zejtarëve e profesionistëve të marrin njërin nga profetët si udhëhapësin dhe të parin në çdo mjeshtëri e në profesione. Për shembull, detarët të marrin Hazreti Nuhun a.s.; orëndreqësit të marrin Hazreti Jusufin a.s.; rrobaqepësit të marrin Hazreti Idrisin a.s. e kështu me radhë...

Me të vërtetë, meqenëse dijetarët e saktë dhe shkenca e retorikës kanë rënë dakord se çdo vërset i Kur'anit përmban disa aspekte udhëzimi dhe instruksioni, atëherë vërsetet e mrekullive të profetëve, të cilët janë më të ndritshmit e Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm, nuk janë secili prej tyre tregime e ngjarje historike, por ato përmbajnë shumë kuptime udhëzimi. Po, duke përmendur mrekullitë e profetëve, ai gjurmon e shënon limitin përfundimtar të shkencës së njerëzimit dhe të industrisë. Ai tregon me gisht qëllimet më të skajshme që mund të arrijë njerëzimi. Ai specifikon objektivat e tij përfundimtare, dhe pastaj e nxit dhe e shtyn njerëzimin për ta arritur atë synim. Ashtu si e shkuara që është magazina e farnave të së ardhmes dhe pasqyra e cilësive të saj, po ashtu e ardhmja është një fushë e lërueshme e së shkuarës dhe pasqyra e gjendjeve të saj. Tani ne

do të shpjegojmë vetëm pak shembuj të atij burimi më të gjërë si shembull... Për shembull, vërseti:

وَ لِسُلَيْمنَ الرِّيحَ غُدُوُّهَا شَهْرٌ وَرَوَاحُهَا شَهْرٌ

"Edhe Sulejmanit (Ne ia nënshtruam atij) erën, (fluturimi) i paraditës ishte sa (udhëtimi) një muaj, dhe (fluturimi) i pasditës ishte sa (udhëtimi) një muaj."[241]

i cili duke përshkruar një nga mrekullitë e Hazreti Sulejmanit a.s., nënshtrimin e erës, thotë: ***"Hazreti Sulejmani përshkoi distancën e dy muajve në një ditë duke fluturuar përmes ajrit."*** Kështu, ai sugjeron me këtë, se rruga është hapur për njeriun për ta mbuluar një distancë të tillë në ajër. Është sikur Zoti xh.sh. të thonte në kuptimin e këtij ajeti:

"O njeri! Meqenëse rruga është e hapur për ty, arrije këtë nivel dhe afrohu tek ai! Dhe në kuptim, Zoti i Gjithëfuqishëm është duke thënë nëpërmjet gjuhës së këtij vërseti: "O njeri! Unë e ngjita një nga shërbëtorët e Mi në ajër meqenëse ai i braktisi dëshirat e nefsit të tij. Në qoftë se edhe ti gjithashtu do ta braktisje përtacinë e nefsit dhe të përfitoje shumë nga disa ligjet e mia në kozmos, edhe ti gjithashtu mund të ngjitesh." Dhe vërseti:

فَقُلْنَا اضْرِبْ بِعَصَاكَ الْحَجَرَ فَانْفَجَرَتْ مِنْهُ اثْنَتَا عَشْرَةَ عَيْنًا

"Dhe Ne i thamë: Bjeri gurit me shkopin tënd." Pastaj që andej u derdhën me vrull dymbëdhjetë burime."[242] deri në fund... i cili shpjegon një mrekulli të Hazreti Musait a.s.. Vërseti tregon se thesaret e Mëshirës të fshehura në tokë mund të nxirren e të përfitohen me mjete të thjeshta. Madje edhe në vende të forta si shkëmbinjtë; uji i jetës mund të nxirret me një shkop. Kështu, nëpërmjet këtij kuptimi, vërseti i thotë njeriut:

"Ti mund të gjesh shkëlqimin më të hollë të mëshirës, ujin e jetës, me një shkop. Ky ajet i flet njerëzimit me këtë kuptim: Ejani, punoni dhe gjejeni atë!"

Dhe në kuptim, All-llahu i Gjithëfuqishëm thotë nëpërmjet gjuhës aluduese të vërsetit:

---

[241] Kur'an, 34: 12

[242] Kur'an, 2: 60

"O njeri! Meqenëse Unë i dhashë dorës së njërit prej shërbëtorëve të Mi, i cili besoi tek Unë, një shkop të tillë që ai të nxirrte ujin e jetës nga ku të dëshironte, në qoftë se edhe ti gjithashtu, nëse do të mbështeteshe tek ligjet e Mëshirës sime, mund ta arrish atë duke shpikur një vegël që t'i ngjasojë atij shkopi ose e përafërt me të. Prandaj, eja dhe bëj kështu!"

Kështu, një nga kontributet më të rëndësishme të përparimit të njeriut është shpikja e një mjeti që e bën ujin të vërshojë nga shumica e vendeve nëpërmjet përdorimit të tij. Ky vërset gjurmon e zbulon qëllimin përfundimtar dhe limitet e tij dhe përfundon përtej tyre. Ashtu si vërseti i mëparshëm që përcaktoi pikat më të largëta përfundimtare, dhe skajin më të largët tek i cili mund të arrijnë aeroplanët e sotëm... Dhe për shembull:

وَأُبْرِئُ الْاَكْمَهَ وَالْاَبْرَصَ وَأُحْيِى الْمَوْتَى بِاِذْنِ اللّٰهِ

"Unë do të shëroj atë që ka lindur i verbër dhe atë që vuan nga lebroza, dhe do të ngjall të vdekurin me vullnetin e lejen e All-llahut."[243], i cili lidhet me një mrekulli të Hazreti Isait a.s. (Jezusit).

Ashtu si Kur'ani që në mënyrë të qartë e nxit njeriun për të ndjekur sjelljet e larta të Isait a.s., po ashtu ai me nënkuptim e nxit atë drej Artit të lartësuar dhe drejt mjekësisë Hyjnore për të cilën ai ishte profesori i parë. Ky ajet tregon:

"Ilaçet mund të gjenden madje edhe për sëmundjet më kronike, prandaj mos u dëshpëro, o njeri! Dhe mos e këput shpresën, o ti, që je provuar me fatkeqësi, sepse çdo sëmundje, sido që të jetë, ka ilaç dhe kurimi i saj është i mundshëm, prandaj kërkoje, gjeje e zbuloje. Madje edhe vdekja mund të kurohet me një nga ngjyrat e jetës së përkohshme!", dhe në kuptim Zoti i Gjithëfuqishëm është duke thënë nëpërmjet një gjuhe figurative të këtij vërseti:

"O njeri! Unë i dhash dy dhurata njërit prej shërbëtorëve të Mi, i cili braktisi botën për Mua. Njëra ishte ilaçi për sëmundjet shpirtërore, dhe tjetra ishte ilaçi për sëmundjet fizike. Kështu, zemrat e vdekura u ngritën dhe erdhën në jetë nëpërmjet dritës së udhëzimit. Dhe njerëzit e

[243] Kur'an, 3: 49

sëmurë të cilët ishin si të vdekurit, gjetën shëndet nëpërmjet një fryme dhe ilaçit të tij. Edhe ti gjithashtu, o njeri, mund të gjesh shërim për çdo sëmundje në farmacinë e Urtësisë Sime.

Puno dhe gjeje atë! Në qoftë se ti e kërkon, me siguri ti do ta gjesh." Kështu, ky vërset gjurmon limitin më të largët dhe objektivat më të skajshme që synon të përparojë aktualisht mjekësia njerëzore. Dhe për shembull, vërsetet:

وَاَلَنَّا لَهُ الْحَدِيدَ ۞ وَآتَيْنَاهُ الْحِكْمَةَ وَفَصْلَ الْخِطَابِ

"Dhe Ne ia bëmë atij edhe hekurin të butë."[244] *"Dhe Ne i dhamë atij urtësi dhe gjykim të drejtë në fjalë e vendim."*[245] të cilat janë rreth Hazreti Davudit a.s., dhe وَاَسَلْنَا لَهُ عَيْنَ الْقِطْرِ *"Dhe Ne bëmë që të rrjedhë për të burim tunxhi."*[246] i cili është rreth Hazreti Sulejmanit a.s.**.**

Këto tregojnë se zbutja e hekurit është një nga mirësitë më të mëdha Hyjnore, nëpërmjet të cilit tregohet virtyti i njërit prej profetëve më të mëdhenj. Në të vërtetë, zbutja e hekurit, domethënë, ta bësh atë si brumë, dhe shkrirja e bakrit, zbulimi i mineraleve dhe nxjerrja e tyre, është origjina, burimi, baza dhe themelet e të gjitha industrive materiale të njerëzimit.

Dhe kështu, ky vërset tregon: ***"Një mirësi e madhe iu dha një profeti të madh dhe kalifit të Zotit në tokë në formën e një mrekullie të madhe, e cila ishte zbujta e hekurit. Dhe duke e bërë atë të butë si brumi dhe të hollë si një fije peri dhe duke e shkrirë bakrin, këto janë mjetet për shumicën e industrive të përgjithshme."***

Meqenëse urtësia iu dha gjuhës së njërit i cili ishte edhe profet edhe kalif, domethënë, njërit i cili ishte edhe udhëheqës shpirtëror, edhe material, si dhe artizanati dhe industria iu dhuruan dorës së tij, ashtu siç nxit kjo në mënyrë të qartë drejt urtësisë së gjuhës së tij, po ashtu ndodhet një shenjë e cila gjithashtu inkurajon drejt artizanatit e mjeshtërisë në dorën e tij. Nëpërmjet gjuhës aluduese të këtij vërseti, në kuptim Zoti i Gjithëfuqishëm është duke thënë:

---

[244] Kur'an, 34: 10
[245] Kur'an, 38: 20
[246] Kur'an, 34: 12

"O bijtë e Ademit! Unë i dhashë një urtësi të tillë gjuhës dhe zemrës së njërit prej shërbëtorëve të Mi, i cili iu bind urdhërave të Mia dhe detyrimeve saqë ai e shpallte vendimin për gjithçka me një qartësi të plotë dhe tregonte të vërtetën. Dhe Unë i dhashë atij një art të tillë në dorën e tij saqë ai mund ta kthente hekurin në çdo formë në dorën e tij si dyll. Ai siguroi një fuqi të fortë për kalifatin e tij dhe për mbretërinë. Meqenëse kjo çështje ishte e mundur, ajo iu dha atij. Ajo është edhe e rëndësishme, dhe ju keni shumë nevojë për të në jetën tuaj shoqërore. Atëherë në qoftë se edhe ju gjithashtu do t'u bindeni urdhërave të Mia në krijim, ajo urtësi dhe ai artizanat do t'u jepet edhe ju gjithashtu. Në rrjedhën e kohës, ju mund ta arrini atë dhe t'i afroheni asaj."

Kështu, progresi më i madh i njeriut, lidhur me industrinë, dhe arritja e fuqisë më të madhe të tij është nëpërmjet zbutjes së hekurit dhe shkrirjes së bakrit. Në vërset, fjala الْقِطْرِ *"kitr"* përdoret për të përshkruar bakrin.

Këto vërsete e drejtojnë shikimin e njeriut drejt kësaj të vërtete, dhe ato me rreptësi i paralajmëruan njerëzit e kohës së mëparshme të cilët nuk e vlerësuan se sa e rëndësishme ishte kjo, si dhe ata që janë përtacë në kohët moderne... Dhe për shembull, vërseti,

قَالَ الَّذِى عِنْدَهُ عِلْمٌ مِنَ الْكِتَابِ اَنَا آتِيكَ بِهِ قَبْلَ اَنْ يَرْتَدَّ اِلَيْكَ طَرْفُكَ
فَلَمَّا رَآهُ مُسْتَقِرًّا عِنْدَهُ

"Njëri që kishte dije për librat (e shenjtë) tha: 'Unë do të ta sjellë atë ty sa të hapësh e të mbyllësh sytë!' Pastaj, kur (Sulejmani) e pa atë të vendosur para tij.."[247] deri në fund... i cili tregon këtë ngjarje të jashtëzakonshme, me qëllim që ta sjellë Fronin e Belkisit tek ai, njëri nga ministrat e Hazreti Sulejmanit a.s., të cilit i ishte dhënë shumë dije në shkencën e tërheqjes, nëpërmjet të cilit Zoti xh.sh. bënte keramete, tha: ***"Unë do ta kem Fronin këtu para se ti të mund të pulitësh sytë e tu."***

Kështu, vërseti sugjeron se është e mundur t'i bësh gjërat të jenë të pranishme nga distanca të largëta, ose vetë ato, ose format e tyre. Dhe është një fakt që Zoti i Gjithëfuqishëm ia dhuroi këtë Hazreti

[247] Kur'an, 27: 40

Sulejmanit a.s., i cili u nderua si me mbretërim, po ashtu edhe me profetësi, në formën e një mrekullie me qëllim që nëpërmjet saj ai të kishte mundësi që personalisht të informohej pa lodhje për të gjitha trevat e mbretërisë së tij të gjerë dhe të shikonte gjendjen e nënshtetasve të tij dhe të dëgjonte për dertet e tyre. Pra, kjo mrekulli iu dha Sulejmanit a.s. si një mjet për dëlirësinë e tij dhe drejtësinë. Kjo do të thotë, në qoftë se njeriu mbështetet tek Zoti i Gjithëfuqishëm, si Sulejmani a.s., i cili e kërkoi atë me gjuhën e dëlirësisë së tij, edhe ai në qoftë se kërkon nga Krijuesi me gjuhën e aftësisë së tij dhe në qoftë se ai do t'u përshtatej ligjeve të Tij në univers dhe favorit Hyjnor, është e mundur që bota të transformohej e të bëhej si një qytet për të.

Domethënë, ndërsa froni i Belkisit ishte në Jemen, në çast ai qe i pranishëm në Damask, ose forma e tij ishte prezent dhe u shikua. Dhe sigurisht pamjet e njerëzve përreth Fronit ishin të pranishëm dhe zërat e tyre u dëgjuan.

Kështu, ky vërset tregon në mënyrë madhështore tërheqjen dhe sjelljen e formave e të zërave nga distanca të largëta, dhe në efekt thotë: ***"O mbretër dhe sundimtarë! Në qoftë se dëshironi të sundojë drejtësia e pastër në mbretëritë tuaja, përpiquni të shikoni e të kuptoni faqen e tokës, ashtu si Sulejmani, dhe ndiqeni atë. Sepse duke u ngritur tek niveli i të qënit i informuar kurdo si të dëshironte rreth çdo ane të mbretërisë së tij, një sundimtar i drejtë dhe një mbret i cili kujdeset shumë për nënshtetasit e tij shpëton nga përgjegjësia, dhe mund të veprojë me drejtësi të plotë."***

Dhe Zoti i Gjithëfuqishëm në efekt thotë nëpërmjet gjuhës aluduese të vërsetit: *"O bijt e Ademit! Unë i dhashë njërit prej shërbëtorëve të Mi një mbretëri të gjërë, dhe me qëllim që të vepronte krejtësisht me drejtësi brenda saj, unë i dhashë atij të njohë personalisht për të gjitha situatat dhe ngjarjet që ndodhen atje. Dhe meqenëse Unë u kam dhënë të gjithë njerëzve, nga natyrat e tyre, aftësinë për të qenë kalifë në tokë, unë u dhashë atyre gjithashtu kapacitetin për të shikuar, atëherë konsideroje dhe kuptoje faqen e tokës në përputhje me atë aftësi, meqë Urtësia Ime e kërkoi atë."*

Në qoftë se njeriu nuk mund ta arrijë këtë pikë me personin e tij, ai mund ta arrijë atë me llojin e tij; në qoftë se nuk mund ta arrijë materialisht, ai e arrin atë në kuptim – siç ndodh me evlijatë e drejtë, (shenjtorët). Atëherë ju mund të përfitoni nga kjo mirësi e madhe që u

është dhuruar ju. Prandaj, ejani t'ju shoh e përpiquni me punë serioze, dhe orvatuni shumë! Me kusht që ju të mos harroni detyrat tuaja të adhurimit, punoni që ta ktheni faqen e tokës në një kopsht, që të shikoni të gjitha anët e tij dhe të dëgjoni zërat dhe ndodhitë e tij.

I kushtoni vëmendje dekretit të të Gjithëmëshirshmit!"

هُوَ الَّذِى جَعَلَ لَكُمُ ٱلاَرْضَ ذَلُولاً فَامْشُوا فِى مَنَاكِبِهَا
وَكُلُوا مِنْ رِزْقِهِ وَاِلَيْهِ النُّشُورُ

"Ai është i Cili e ka bërë tokën të dobishme dhe të përshtatshme për ju, kështu që ecni nëpër rrugë dhe hani nga rizku i Tij dhe tek Ai do të jetë ringjallja."[248]

Kështu, vërseti i lartëpërmendur aludon për limitin më të skajshëm në një përparim shumë të madh për tërheqjen e pamjeve dhe të zërave, tingujve, njëri prej arteve më të holla të njeriut, dhe aludon për nxitje.

Dhe, për shembull, vërsetet, مُقَرَّنِينَ فِى ٱلاَصْفَادِ *"Si dhe të tjerë të lidhur në pranga."*[249] Deri në fund...

وَمِنَ الشَّيَاطِينِ مَنْ يَغُوصُونَ لَهُ وَيَعْمَلُونَ عَمَلاً دُونَ ذلِكَ

"Edhe nga shejtanët (prej xhindëve) kishte shumë që zhyteshin për të dhe bënin punë të tjera përveç kësaj..."[250] deri në fund... pohojnë se Hazreti Sulejmani a.s., nënshtroi xhindet, shejtanët dhe shpirtrat e këqij dhe, duke penguar të keqen e tyre, ai i bëri ata të shërbejnë në çështje të dobishme, dhe vërsetet thonë: ***"Xhindët, banorët më të rëndësishëm të tokës pas njeriut, të cilët janë të vetëdijshëm, mund t'i shërbejnë njeriut. Kontakti mund të bëhet me ta. Gjithashtu edhe shejtanët mund të detyrohen të heqin dorë nga armiqësia, dhe duan apo nuk duan, t'i shërbejnë njeriut, ashtu siç i nënshtroi All-llahu për njërin midis shërbëtorëve të Tij i cili u bindej urdhrave të Tij."*** Dhe nëpërmjet gjuhës aluduese të vërsetit, në kuptim, Zoti i Gjithëfuqishëm është duke thënë: "O njeri! Unë i bëra xhindët, shejtanët, dhe të këqijtë

[248] Kur'an, 67: 15
[249] Kur'an, 38: 38
[250] Kur'an, 21: 82

e tyre t'i binden njërit prej shërbëtorëve të Mi i cili m'u bind Mua. Në qoftë se edhe ti gjithashtu do t'u nënshtroheshe urdhërave të Mia, shumë qënie, madje edhe xhindët e shejtanët mund të të nënshtrohen ty."

Kështu, këto vërsete skicojnë limitin më të fundit dhe përcaktojnë format më të mira për të përfituar, madje ato hapin rrugë gjithashtu për sjelljen e shpirtrave dhe për të biseduar me xhindin, i cili filtroi nga kombinimi i artit dhe i shkencës së njeriut, dhe ka shfaqur çfarë fshihet tek ai prej fuqive dhe ndjenjave të tij të jashtëzakonshme, materiale e shpirtërore. Por, çështja nuk është si në kohën tonë aktuale në të cilën ata që merren me këto çështje janë bërë gazi i botës dhe, madje janë bërë lodra në dorën e xhindit të cilët ndonjëherë pretendojnë dhe e quajnë vetveten shpirtrat e të vdekurve. Dhe u bënë të nënshtruar ndaj shejtanëve dhe shpirtrave të këqij. Por nënshtrimi i tyre, i xhindëve, ndodh vetëm nëpërmjet mistereve të Kur'anit, kështu duke shpëtuar nga e keqja e tyre.

Gjithashtu, vërsetet rreth Hazreti Sulejmanit a.s. duke aluduar për shpirtërat, dhe tërheqja e djajve nga ana e tij dhe nënshtrimi i tyre,

dhe disa vërsete të tjerë si, فَاَرْسَلْنَا اِلَيْهَا رُوحَنَا فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا

"Pastaj Ne i dërguam asaj Ruhun Tonë (melekun Xhibril) dhe ai iu paraqit përpara saj tamam në formë njeriu."[251], tregojnë edhe tërheqjen e shpirtrave, edhe qëniet e shpirtrave duke marrë forma. Por tërheqja e shpirtrave të pastër, e aluduar këtu në vërsete, nuk është në mënyrën që kryejnë bashkëkohësit duke i sjellë shpirtrat në vendet e tyre dhe në vendet e zbavitjeve të tyre, gjë e cila është një mungesë respekti, shpërfillje dhe që nuk u shkon atyre shpirtrave të respektuar seriozë, të cilët e mbushin një botë krejtësisht serioze dhe për një qëllim serioz. Por sjellja e shpirtrave është e mundur, ashtu siç ndodh dhe siç e kryejnë evlijatë e drejtë për një çështje serioze dhe për një qëllim të lartë të synuar si shembulli i Muhjiddin Ibn Arabi të cilët takoheshin me ato shpirtra të mirë kur të donin, u tërhoqën pas tyre dhe formuan lidhje, duke shkuar në vendet e tyre, deri në një far mase duke u afruar tek bota e tyre dhe duke përfituar nga shpirtësia e tyre. Për këtë aludojnë vërsetet dhe, brenda këtij aluzioni, bëjnë të kuptueshme se ato po e

[251] Kur'an, 19: 17

inkurajojnë dhe po e nxisin njeriun për atë botë. Vërsetet skicojnë limitin më të skajshëm të arteve të fshehura dhe të shkencave të këtij lloji dhe i tregojnë ato në formën më të mirë. Për shembull, vërsetet rreth mrekullive të Hazreti Dautit (Davidit) a.s.:

اِنَّا سَخَّرْنَا الْجِبَالَ مَعَهُ يُسَبِّحْنَ بِالْعَشِيِّ وَالْاِشْرَاقِ ۞ يَا جِبَالُ اَوِّبِى مَعَهُ وَالطَّيْرَ وَاَلَنَّا لَهُ الْحَدِيدَ dhe عُلِّمْنَا مَنْطِقَ الطَّيْرِ

"Me të vërtetë që Ne i bëmë malet të lartësojnë lavditë Tona bashkë me të gjithë pasditën dhe gjithë paraditën."[252]

Dhe vërtet që Ne i dhuruam Davudit mirësi prej Nesh (duke i thënë): "O ju male! Lavdërojeni (All-llahun) bashkë me të! Edhe ju zogj! Dhe Ne ia bëmë atij edhe hekurin të butë."[253]

"Na është mësuar gjuha e shpendëve dhe na është dhuruar gjithçka."[254]*,*

tregojnë se Zoti i Gjithëfuqishëm u dha lavdërimeve dhe lartësimeve të Hazreti Davudit a.s. një fuqi të tillë dhe një zë aq të lartë e të këndshëm saqë ato i sollën malet në ekstazë, secili prej tyre si të ishte një gramafon i madh ose një njeri, formuan një rreth në horizont përreth recituesit kryesor dhe gjithashtu deklaruan lavdërimet e lartësimet për All-llahun. Doja ta dija, a është kjo e mundur? A është ajo e vërteta?

Po, ajo është e vërteta. Çdo mal me shpella mund të flasë me çdo njeri në gjuhën e njeriut si një papagall, sepse nëpërmjet jehonës, në qoftë se ti do të thoje ***"El hamdu lil-lah"*** përpara një mali, edhe mali gjithashtu tamam si ti do të thonte: ***"El hamdu lil-lah"*** *"Lavdërimet i takojnë All-llahut"*. Meqenëse Zoti i Gjithëfuqishëm u ka dhuruar maleve këtë aftësi, atëherë është e mundur që kjo aftësi të zbulohet dhe të shtrihet më shumë dhe mund të lulëzojë.

Dhe meqenëse Zoti xh.sh. i dha Hazreti Davudit a.s. kalifatin e tokës së bashku me profetësinë e tij, me një mënyrë të veçantë e zbuloi farën e asaj aftësie tek ai, e zhvilloi atë dhe e shtriu si një mrekulli tek

---

[252] Kur'an, 38: 18

[253] Kur'an, 27: 16

[254] Kur'an, 27: 16

ai, duke iu përshtatur çështjeve të shtrira të profetësisë dhe mbretërimit të gjerë, saqë malet e mëdha e ndoqën atë si ushtarë, si studentë ose si ndjekës, dhe me urdhrin e Hazreti Davudit a.s. dhe me gjuhën e tij deklaruan lavdërimet dhe lartësimet e Krijuesit të Gjithëlavdishëm. Çfarëdo që thonte Hazreti Davudi a.s., ato e përsërisnin. Tani në kohën e sotme, për shkak se mjetet e komunikimit janë shumuar e zhvilluar, një komandant i fuqishëm mund ta bëjë ushtrinë e tij të madhe të shpërndarë në male të thotë: përnjëherësh ***"All-llahu Ekber"*** *"Zoti është më i madhi!"*, dhe mund t'i bëjë malet të flasin e t'i sjellë ato në trazirë e emocion shpirtëror. Meqenëse një komandant i njerëzve mund t'i bëjë malet të flasin "në formë metaforike" me gjuhën e atyre që janë të pranishëm në male, sigurisht një komandant madhështor i Zotit të Gjithëfuqishëm, mund t'i bëjë ato të flasin 'me të vërtetë', dhe mund t'i bëjë ato të recitojnë lavdërimet e Zotit xh.sh..

Përveç kësaj, unë kam shpjeguar në Fjalët e mëparshme se të gjitha malet kanë një personalitet kolektiv ose një identitet kolegjial dhe bëjnë lavdërime e adhurim në një mënyrë të përshtatshme për secilin. Domethënë, ashtu siç recitojnë të gjithë malet nëpërmjet misterit të jehonës me gjuhët e njerëzve, po ashtu ato e lavdërojnë Krijuesin e Gjithëlavdishëm me gjuhët e tyre të veçanta. Gjithashtu, vërseti:

وَالطَّيْرَ مَحْشُورَةً ۩ عُلِّمْنَا مَنْطِقَ الطَّيْرِ

"(Po kështu) edhe zogjtë mblidheshin (të gjithë bashkë me të)."[255]

"(O njerëz) Na është mësuar gjuha e shpendëve"[256],

tregojnë se Zoti i Gjithëfuqishëm u dhuroi Hazreti Davudit dhe Sulejmanit a.s. dijeninë e gjuhëve të llojeve të zogjve, dhe njohjen e gjuhëve të aftësive të tyre, domethënë çfarë gjërash e punësh u përshtaten atyre, dhe si mund të përfitohet prej tyre. Po, meqenëse ajo është e vërteta, dhe meqenëse faqja e tokës është një tryezë e mbushur e të Gjithëmëshirshmit e cila u vendos e u shtrua në nderim të njeriut, atëherë shumica e kafshëve dhe e shpendëve, të cilat përfitojnë prej kësaj tryeze, mund t'i nënshtrohen njeriut dhe t'i shërbejnë atij. Njeriu i përdor disa nga më të voglat e tyre, bletën e mjaltit dhe krimbin e

[255] Kur'an, 38: 18

[256] Kur'an, 27: 16

mëndafshit, dhe nëpërmjet inspirimit Hyjnor ai ka hapur një rrugë të fuqishme përfitimi. Duke përdorur pëllumbat në detyra të ndryshme dhe duke i bërë zogjtë ashtu si shembulli i papagallëve, të flasin, ai u ka shtuar gjëra të holla e të bukura vlerave të qytetërimit njerëzor. Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se gjuha e aftësisë së zogjve të tjerë dhe të kafshëve do të njiheshin, atëherë ndodhen shumë specie të cilat do të mund të përdoreshin në detyra të rëndësishme ashtu si vëllezërit e tyre, kafshët shtëpiake.

Për shembull, kundër flamës, murtajës së karkalecave: Në qoftë se do të njihej gjuha e shturave (zogj të vegjël shtegtarë), të cilët i hanë dhe i shkatërrojnë karkalecët, dhe nëse do të rregulloheshin lëvizjet e tyre, në çfarë shërbimi të çmueshëm do të mund të përdoreshin ato falas, pa pagesë. Kështu, ky vërset skicon limitin më të skajshëm lidhur me nënshtrimin e zogjve dhe përfitimin e tyre në këtë mënyrë që gjërat e pajeta të flasin si një telefon ose gramafon dhe lidhur me shfrytëzimin e zogjve. Vërseti skicon qëllimin më të largët. Ai tregon me gisht në mënyrën më madhështore duke na nxitur drejt saj. Kështu, nëpërmjet gjuhës aluduese të këtyre vërseteve, Zoti i Gjithëfuqishëm është duke thënë:

"O njerëz! Me qëllim që të mbrohet profetësia e tij dhe drejtësia e plotë e mbretërimit të tij dhe me qëllim që ato të ishin mjetet e nderimit të tij, Unë ia nënshtrova një shërbëtori midis llojit tuaj, i cili ishte plotësisht i bindur ndaj Meje, krijesat e mëdha në sundimet e Mia dhe i bëra ato të flasin. Unë i bëra shumicën e trupave të Mia dhe kafshët shërbëtorë për të. Prandaj, meqenëse Unë i kam besuar secilit nga ju amanetin më të lartë, për mbajtjen e të cilit ngurruan e refuzuan qiejt, toka dhe malet, dhe ju dhashë aftësinë e të qënit kalifi Im në tokë, atëherë edhe ju duhet që t'i bindeni e t'u nënshtroheni urdhrave të Atij në Dorën e të Cilit janë frerët e të gjitha këtyre krijesave dhe drejtimi i tyre, me qëllim që krijesat nën sundimin e Tij mund t'ju jepen edhe ju gjithashtu, dhe që ju të mund të fitoni në Emrin e të Vetmit i Cili i mban frerët e tyre, në qoftë se ju do të ngriheshit në një pozitë që i përshtatet aftësive dhe dhuntive tuaja..."

Meqenëse e vërteta është kështu, përpiqu, o njeri, që të mos merresh me gjëra të pakuptimta, as të luash me gjëra që s'kanë dobi, si të preokupuarit me gramafona, si loja me pëllumba dhe bërja e tyre të dërgojnë letra, dhe duke i bërë papagallët të flasin, por përpiqu në

kërkim të zbavitjes më të këndshme, më të lartë e më të bukur dhe argëtohu me diçka që është më e shijshmja e argëtimeve... Atëherë bëji malet për ty gramafonë gjigantë, ashtu si të Davudit dhe kënaqi veshët me tingujt e lavdërimeve dhe të lartësimeve të pemëve dhe bimëve të cilat nxjerrin zëra të hollë e të ëmbël thjesht me prekjen e flladit tek ato dhe ato sikur të ishin tejza të zërit dhe recitime bukurtingëlluese. Me këtë dhikr të lartë, malet të tregojnë ty mijëra gjuhë përkujtuese, lavdëruese e lartësuese, dhe shfaqin para teje natyrën e vërtetë të tyre si krijesa të çuditshme të cilat recitojnë lavdërimet Hyjnore; dhe shumica e zogjve mund të vishen në formën e një miku të ngushtë ose të një shërbëtori të bindur, ashtu si pupëza e Sulejmanit a.s.. Dhe atëherë ato mund të bëhen shërbyes të bindur ndaj teje dhe mund të të zbavisin e të të shtyjnë drejt plotësimeve, arritjeve dhe dhuntive për të cilat ti je i aftë, dhe nuk të bëjnë të biesh nga pozita e kërkuar nga të qënit qënie njerëzore; atëherë mos u josh pas zbavitjeve që u përmendën më lart të cilat ishin të pakuptimta, me qëllim që mos të të zbresin ty nga rangu që i takon humanizmit.. Dhe për shembull, në vërsetin:

قُلْنَا يَا نَارُ كُونِى بَرْدًا وَسَلاَمًا عَلَى اِبْرَاهِيمَ

"Ne thamë: 'O zjarr! Bëhu i ftohtë dhe paqe e siguri për Ibrahimin!"[257], i cili është rreth një mrekullie të Hazreti Ibrahimit a.s., ndodhen tre tregues të hollë:

I pari: Ashtu si shkaqet e tjera materiale, zjarri nuk vepron nga vetvetja, pra çështja e tij nuk është në dorën e vet, ai nuk vepron si të dojë sipas tekave të tij dhe natyrës, verbërisht, por ai e kryen detyrën nën një urdhër. Domethënë, ai nuk e dogji Hazreti Ibrahimin a.s., sepse ishte i urdhëruar: ***"Mos e digj!"***

I dyti: Ndodhet një gradë e nxehtësisë e cila djeg nëpërmjet ftohtësisë së saj. Domethënë, ajo ka një efekt si djegia. Nëpërmjet fjalës, سَلاَمًا[258] *"Bëhu i ftohtë, paqe",* Zoti i Gjithëfuqishëm është duke i thënë ftohtësisë: ***"Mos e digj atë me ftohtësinë tënde, ashtu siç nuk e dogji atë nxehtësia!"***

---

[257] Kur'an, 21: 69

[258] Njëri nga komentet Kur'anore përmend: Në qoftë se Ai nuk do të kishte thënë: سَلاَمًا *Bëhu i ftohtë! (paqe)*, ai do ta kishte djegur atë me ftohtësinë e tij.

Zjarri në atë gradë shfaq një efekt me ftohtësinë e tij si djegia. Ai është edhe zjarr, edhe i ftohtë. Në të vërtetë zjarri, në shkencën e natyrës, ka grada të ndryshme. Prej atyre është një gradë në formën e një zjarri të bardhë, gjendja e 'nxehtësisë së bardhë', e cila nuk shpërndahet përreth saj. Meqenëse ajo e tërheq nxehtësinë rreth saj për tek vetja, me këtë lloj të ftohtë, ajo i ngrin lëngjet që janë përreth tij si ujë, dhe në efekt i djeg ato nëpërmjet të ftohtit të tij. Kështu i ***"Ftohti i madh"*** është një kategori zjarri që djeg nëpërmjet të ftohtit të tij. Atëherë ekzistenca e tij është e domosdoshme në Xhehennemin që përfshin të gjitha gradat e zjarrit dhe të gjitha llojet.

I treti: Ashtu siç ndodhet një substancë jolëndore si imani (besimi), i cili është një pengesë për efektet e zjarrit të Xhehennemit dhe i shpëton besimtarët prej tij, dhe ashtu siç është Islami një armaturë mbrojtëse dhe një kështjellë e fortifikuar kundra zjarrit, po ashtu ndodhet një substancë lëndore e cila pengon efektet e zjarrit të kësaj bote, sepse siç kërkohet nga Emri i të Gjithurtit, meqenëse kjo botë është banesa e urtësisë, Zoti i Gjithëfuqishëm i kryen aktet e Tij nën perden e shkaqeve. Prandaj, zjarri nuk e dogji trupin e Hazreti Ibrahimit, ashtu siç nuk e dogji as mantelin dhe veshjen e tij. Ai u dha atyre një gjendje për t'i rezistuar zjarrit. Pra, ashtu siç nuk dogji Ibrahimin, nuk i dogji as rrobat e tij gjithashtu. Kështu, nëpërmjet këtij aluzioni, në kuptim vërseti është duke thënë:

"O populli i Ibrahimit; bëhuni si Ibrahimi! Me qëllim që veshja e juaj lëndore dhe jolëndore të jetë veshja e takvasë, fetarisë, e cila është veshja e Ibrahimit a.s., dhe që të jetë një kështjellë mbrojtëse dhe një armaturë penguese në Dynja e në Ahiret, kundra armikut tuaj më të madh, zjarrit. Visheni shpirtin tuaj me besim të pastër në Zotin xh.sh., dhe kjo do të jetë mburoja juaj kundra zjarrit të Xhehennemit. Gjithashtu ndodhen disa substanca të cilat All-llahu i ka fshehur në tokë për ju e cila do t'ju mbrojë ju nga e keqja e zjarrit. Atëherë, i kërkoni ato substanca mbrojtëse, i nxirrni dhe vishuni me to." Kështu, një nga zbulimet e rëndësishme të njeriut dhe një nga shkallët e përparimit të tij ishte zbulimi i një substance të cilën nuk e djeg zjarri; dhe ai e veshi vetveten me rroba që i rezistojnë zjarrit. Dhe shiko se çfarë veshje të lartë, të hollë e të bukur thur ky vërset në tezgjahun e ***"Hanifen muslimen"***, e cila nuk griset kurrë, por do të mbetet përjetësisht...

Dhe për shembull, vërseti:

وَعَلَّمَ آدَمَ ٱلْاَسْمَاءَ كُلَّهَا

"Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e të gjitha gjërave,"[259] thotë: ***"Mrekullia më e madhe e Hazreti Ademit a.s. në çështjen e kalifatit të lartë ishte të mësuarit e Emrave Hyjnorë."***

Atëherë, ashtu si mrekullitë e profetëve të tjerë që secila aludon për një çudi, për një ngjarje të jashtëzakonshme njerëzore, e veçantë për secilin prej tyre, mrekullia e Hazreti Ademit a.s., i cili ishte babai i të gjithë profetëve dhe hapësi i zyrës së profetësisë, tregon pothuajse në mënyrë të qartë pikat përfundimtare të të gjithë arritjes dhe të përparimit njerëzor, si dhe të qëllimit të tyre përfundimtar. Nëpërmjet gjuhës së aluzionit, ne kuptojmë se Zoti i Gjithëfuqishëm është duke thënë me këtë vërset:

"O bijtë e Ademit! Epërsia e babait tuaj Ademit a.s. në çështjen e kalifatit mbi melekët qëndron në faktin që Unë ia mësova atij të gjitha Emrat; edhe ju bijtë e tij dhe trashëgimtarët e aftësive të tij, duhet t'i mësoni të gjitha Emrat dhe të tregoni vlefshmërinë tuaj përpara të gjitha krijesave në shkallën e amanetit më të madh, sepse rruga është e hapur për ju për t'u ngritur tek pozitat më të larta në univers, u është nënshtruar ju toka, kjo krijesë gjigante. Atëherë nisuni, dilni përpara, kapuni fort pas çdo Emri prej Emrave të bukur, që të ngriheni lartë e të përparoni!.. Por ruhuni! Shejtani e mashtroi babain tuaj një herë dhe përkohësisht ai ra nga Xhenneti në tokë. Prandaj kini kujdes! Në përparimin tuaj, mos e ndiqni Shejtanin, dhe mos e bëni atë mjetin e rënies suaj nga qiejt e urtësisë Hyjnore për në ç'udhëzimin e 'natyrës'. Në mënyrë të vazhdueshme duke ngritur kokën tuaj e duke studiuar me kujdes Emrat e Mi të Bukur, i bëni shkencat tuaja dhe përparimin tuaj si shkallë nëpërmjet të cilave ju të ngjiteni tek ato qiej. Atëherë ju mund të ngjiteni tek Emrat e Mi Hyjnorë, të cilët janë realitetet dhe burimet e shkencave tuaja dhe të arritjeve, dhe ju mund ta shikoni Krijuesin tuaj me zemrat tuaja nëpërmjet teleskopit të atyre Emrave..."

* * *

[259] Kur'an, 2:31

Një pikë e rëndësishme dhe një mister i rëndësishëm

Në shprehjen dhe përshkrimin e të gjitha arritjeve të dijes, të përparimit shkencor dhe të çudirave të teknologjisë të cilat i shfaq njeriu nëpërmjet prirjes dhe aftësive të tij gjithëpërfshirëse me titullin e ***"Të Mësuarit të Emrave"***, në këtë vërset të çuditshëm ndodhet aluzioni i lartë e i hollë që vijon. Të gjitha arritjet dhe plotësimet, e gjithë dija, përparimi, dhe të gjitha shkencat, secila ka një realitet të lartësuar i cili bazohet në njërin nga Emrat Hyjnorë. Duke u mbështetur tek Emri i Cili fshihet nën perde të shumta, që ka shfaqje e manifestime të ndryshme dhe sfera të ndryshme, shkencat, artet dhe arritjet gjejnë plotësimin e tyre dhe bëhen realitet. Përndryshe, ai art ose ajo shkencë do të ishte veçse ndonjë hije e paplotë dhe e mangët...

Për shembull, inxhinieria është një shkencë, realiteti i saj dhe pika e saj përfundimtare është grada tek Emrat e Bukur të Zotit të Gjithëfuqishëm, ***"El-Adil*** dhe ***El-Mukaddir"***, "*I Drejti, Projektuesi"*, dhe arrin të shikojë me të gjithë madhështinë e tyre shfaqjen e urtë të atyre Emrave në pasqyrën e inxhinierisë.

Dhe për shembull, mjekësia është një shkencë, dhe gjithashtu është një profesion, pika e saj përfundimtare dhe realiteti i saj mbështetet tek Emri ***"Esh-Shafi"*** **"***Shëruesi"***, prej Emrave të Bukur Hyjnorë të të Gjithurtit Absolut, kështu mjekësia arrin në plotësimin e saj dhe bëhet një realitet nëpërmjet shikimit të shfaqjeve mëshirëplota të Atij Emri në ilaçet e shpërndara mbi faqen e tokës e cila përfaqëson një farmaci të madhe.

Dhe, për shembull, shkencat natyrore, të cilat diskutojnë realitetin e qënieve, nëpërmjet shikimit të shfaqjeve më të mëdha të Emrit ***"El-Hakim"***, "*i Gjithurti"* -nga Emrat e All-llahut xh.sh.-, në gjërat, të cilat janë manifestime rregulli, rritjeje dhe përkujdesjeje, dhe duke i shikuar këto shfaqje në përfitimet e gjërave dhe në avantazhet e tyre, dhe nëpërmjet arritjes tek Emri dhe duke u bazuar tek Ai Emër, këto shkenca mund të përmbajnë urtësinë e vërtetë. Përndryshe, ato ose transformohen në besëtytni, ose bëhen diçka pa dobi nga pas, ose hapin rrugën e ç'udhëzimit, ashtu si filozofia natyraliste. Ja, këto ishin tre shembuj për ty!.. Ti mund të bësh analogji me këto për shkencat dhe arritjet e tjera.

Kështu, me këtë vërset, Kur'ani i Gjithurtë godet dorën e nxitjes prapa njeriut, e nxit atë nga pas duke e shtyrë për tek pikat më të larta, për tek limitet më të skajshme dhe tek shkallët më përfundimtare, prej të cilave në shkallën e tanishme të përparimit të tij ai është shumë prapa. Ai ia tregon me gisht ato shkallë dhe sikur i thotë: ***"Ec përpara!".*** Duke u mjaftuar sa për tani me këto xhevahire nga thesari më i madh i këtij vërseti, ne po e mbyllim këtë derë...

Dhe, për shembull, Kur'ani i gjithurtë, i cili është mrekullia më e madhe e prijësit të profetëve, Muhammedit a.s.m., i vulës së misionit të profetësisë, për të cilin të gjitha mrekullitë e profetëve të mëparshëm konsiderohen një mrekulli e vetme për të vërtetuar pretendimin e profetësisë së tij; ai është udhëheqësi i profetëve dhe shkaku i krenarisë së universit; ai i shfaqi në detaje me të gjitha shkallët e tyre të gjithë Emrat të cilët iu mësuan Hazreti Ademit a.s., në mënyrë të përmbledhur; ai duke ngritur lart gishtin e tij, nëpërmjet shfaqjes së Lavdisë Hyjnore, u ça më dysh Hëna, dhe duke e ulur atë, nëpërmjet shfaqjes së Bukurisë Hyjnore e bëri ujin të vërshonte si burimi i Keutherit; dhe ai u verifikua dhe u mbështet nga njëmijë mrekulli.

Nëpërmjet vërseteve të qarta të shumta si:

قُلْ لَئِنِ اجْتَمَعَتِ الْاِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَى اَنْ يَاْتُوا بِمِثْلِ هذَا الْقُرْآنِ لاَ يَاْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا

"Thuaj, nëse njerëzimi dhe xhindët do të mblidheshin të gjithë bashkë të nxirrnin ngjasimin e këtij Kur'ani, ata nuk do ta bënin dot përngjasimin e tij, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin."[260], të cilët shprehin pastërtinë e shpjegimit të tij, elokuencën e shprehjes së tij, gjithëpërfshirjen e kuptimeve të tij, dhe lartësinë e ëmbëlsinë e stileve të tij, lidhur me të vërtetën dhe realitetin, të cilat janë më të ndritshmet e aspekteve të mrekullisë së Kur'anit të gjithurtë. Nëpërmjet vërseteve si këto, ai i kthen shikimet e njeriut dhe të xhindit tek aspektet më të qarta dhe më të shndritshme të kësaj mrekullie të përjetshme. Ai i provokon të gjithë njerëzit dhe xhindet. Duke provokuar entuziazmin e miqve të tij dhe kryeneçësinë e armiqve të tij, ai i nxit ata me inkurajim të madh për ta

[260] Kur'an, 17: 88

imituar e kopjuar atë, për t'i përngjasuar atij me fjalët e tyre. Dhe Ai e vendos atë mrekulli në sytë e krijesave në një vend të lartë sikur qëllimi i vetëm i ardhjes së njeriut në këtë botë të ishte vetëm që ta marrë atë mrekulli më të madhe si synimin e tij dhe si parimin udhëzues dhe, duke e shikuar atë, me vetëdije të ecë drejt rezultatit të krijimit të njeriut.

***Shkurtazi**:* Secila nga mrekullitë e profetëve të tjerë a.s. tregon një çudi, ngjarje të jashtëzakonshme, nga çudirat e artit njerëzor ose të profesioneve. Sa për mrekullinë e profetit Adem a.s., ajo tregon indeksin e shkencave dhe degëve të dijes dhe të çudirave e plotësimeve dhe e nxit njeriun për tek ato nëpërmjet treguesve të tyre për tek bazat e atyre mjeshtërive duke aluduar për to në mënyrë të përmbledhur. Ndërsa Kur'ani i Shpjegimit të Mrekullueshëm, mrekullia më e lartë e profetit Muhammed a.s.m., duke shfaqur në detaje realitetin e të mësuarit të Emrave, tregon qartë qëllimin e vërtetë të shkencave dhe të degëve të dijes, të cilat janë të vërteta dhe realitet, dhe plotësimet, arritjet dhe lumturinë që lidhet me këtë botë dhe tjetrën. Dhe me nxitje vërtet të fuqishme, ai e shtyn njeriun drejt tyre. Dhe ai inkurajon e nxit në një mënyrë e cila thotë:

"O njeri! Në qoftë se fytyra e shfaqjeve të Hyjnisë dhe qëllimi më i lartë i krijimit të universit është adhurimi universal i njeriut dhe nënshtrimi ndaj Zotit xh. sh., ndërsa qëllimi më i lartë i krijimit të njeriut është arritja e adhurimit nëpërmjet atyre shkencave dhe plotësimeve." Ai e shpreh këtë në një mënyrë të tillë përmes së cilës ai aludon: ***"Në fundin e kohës, njerëzimi do të derdhet në shkenca e dije. Ai do ta arrijë të gjithë fuqinë nga shkenca. Fuqia dhe sundimi do të kalojnë në dorën e shkencës."***

Gjithashtu, meqenëse Kur'ani i Shpjegimit të Mreku-llueshëm, në mënyrë të përsëritur, vë në krye elokuencën e tij dhe bukurinë e shprehjes, nëpërmjet aluzionit ai thotë:

"Në fundin e kohës, elokuenca dhe bukuria e shprehjes, më të shndritshmet e shkencave dhe degëve të njohjes, do të jenë më të kërkuarat me të gjitha shumëllojshmëritë e tyre. Madje, me qëllim që ta bëjnë njëri-tjetrin që të pranojnë idetë e tyre e të nxjerrin fjalën e tyre, njerëzit do ta gjejnë armën e tyre më efektive në shprehjen elokuente dhe forcën e tyre më të parezistueshme në oratorinë e bukur e të hollë."

Përmbledhja: Shumica e vërseteve të Kur'anit janë një çelës për një thesar të plotësimeve dhe një udhëzues për një thesar të madh shkencor. Në qoftë se dëshiron, ti mund të ngjitesh në qiejt e Kur'anit dhe në yjet e vërseteve të tij dhe, duke i bërë njëzet Fjalët e mëparshme një shkallë me njëzet shkelëza,[261] ngjitu tek ato. Nëpërmjet tyre, shiko se çfarë dielli ndriçues është Kur'ani! Shiko se si ai përhap një dritë të pastër mbi të Vërtetat Hyjnore dhe mbi të vërtetat e krijesave dhe të qënieve! Shikoje se çfarë drite rrezatuese përhap ai!..

Përfundim: Meqenëse vërsetet që lidhen me mrekullitë e profetëve kanë një lloj aluzioni, nënkuptimi, për çudirat e përparimit shkencor dhe industrial në kohën e tanishme dhe kanë një mënyrë shprehjeje e cila sikur skicon limitet e tyre më të skajshme në të ardhmen, dhe meqenëse çdo vërset duke treguar kuptime të shumta në mënyrë të sigurtë gjë që është pranuar me unanimitet nga dijetarët, dhe meqenëse ndodhen urdhra të prerë për të ndjekur e për t'iu bindur profetëve, atëherë së bashku me tregimin e kuptimeve të qarta të vërseteve të lartpërmendura, mund të thuhet se ato tregojnë në mënyrë aluduese rëndësinë e arteve të njeriut dhe të shkencave, dhe i nxisin njerëzit drejt tyre...

* * *

[261] Në të vërtetë, tridhjetë e tre Fjalët, tridhjetë e tre Letrat, tridhjetë e një Shkreptimat dhe trembëdhjetë Rrezet formojnë një shkallë me një qind e njëzet shkelëza... (Autori)

Dy Përgjigje të Rëndësishme për Dy Pyetje të Rëndësishme

E Para: Në qoftë se ti thua*:* "Meqenëse Kur'ani u shpall për njeriun, përse ai nuk i shpreh qartë çudirat e qytetërimit, të cilat janë më të rëndësishmet në vështrimin e Tij? Përse ai mjaftohet vetëm me një shenjë të fshehur, me një aluzion të mbuluar, me një tregues të vogël dhe me një kujtues të dobët?"

Përgjigjja: Sepse të drejtat e çudirave të qytetërimit njerëzor nuk meritojnë më shumë se kaq në diskutimet e Kur'anit, sepse detyra themelore e Kur'anit është të japë mësim rreth plotësimeve dhe akteve në sferën e Hyjnisë dhe në detyrat e gjendjet e sferës së adhurimit. Kështu të drejtat e çudirave njerëzore në ato dy sfera bien tek qënia vetëm një shenjë e dobët dhe një tregues i dobët, një gjurmë e vogël, sepse në qoftë se ato do të kërkonin të drejtat e tyre nga sfera e Hyjnisë, ato do të merrnin shumë pak.

Për shembull, në qoftë se aeroplani[262] i njeriut do t'i kërkonte Kur'anit duke i thënë: "Më jep të drejtën të flas, dhe më jep një vend në vërsetet e tua", atëherë planetët, toka dhe hëna të cilat janë aeroplanët e sferës së Hyjnisë, do të përgjigjeshin në emrin e Kur'anit: "Ti mund ta marrësh vendin tënd këtu aq sa ke madhësinë tënde dhe jo më shumë." Dhe në qoftë se nëndetëset e njeriut do të kërkonin një vend nga vërsetet e Kur'anit, atëherë nëndetëset e asaj sfere, domethënë, toka dhe yjet, –të cilat notojnë në oqeanin e madh të atmosferës dhe të eterit– do të thonin: "Vendi yt midis nesh është aq i vogël sa nuk shihet." Në qoftë se elektriciteti do të kërkonte të drejtën e fjalës dhe dëshiron të futet tek vërsetet e tij me llambat e tij të mahnitshme si yjet, atëherë dritat elektrike të asaj sfere të cilat janë diejt, yjet qëllues, shkreptimat, yjet dhe llambat që zbukurojnë fytyrën e qiejve, do të thonin: "Ti mund të hysh me ne në diskutimet e Kur'anit dhe në shpjegimin e tij aq sa dritë ke". Në qoftë se çudirat e qytetërimit do të kërkonin të drejtat e tyre në lidhje me hollësinë e artit dhe të kërkonin një vend nga vërsetet e tij,

[262] Ndërsa duke e shkruar këtë çështje serioze, në mënyrë të pavullnetshme pena ima u kthye tek ky dialog i hollë, dhe unë e lashë të lirë penën time. Unë shpresoj se stili disi jo serioz të mos e prishë seriozitetin e çështjes...

atëherë një mizë e vetme do t'u thonte atyre: "Heshtni!" "Ju nuk keni asnjë të drejtë, madje as sa njëri prej krahëve të mi! Sepse në qoftë se të gjitha artet e bukura dhe instrumentet e holla të fituara nëpërmjet dëshirës së pjesshme të njeriut, dhe të aftësisë së tij, do të mblidheshin të gjitha bashkë, ato nuk do të ishin aq të çuditshme sa arti i bukur dhe gjymtyrët e holla të trupit tim të vockël...

اِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللّهِ لَنْ يَخْلُقُوا ذُبَابًا وَلَوِ اجْتَمَعُوا لَهُ

"Me të vërtetë që ata të cilëve ju u drejtoheni në vend të All-llahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe sikur të mblidheshin të gjithë së bashku për t'ia arritur qëllimit,"[263] deri në fund... vërseti ju bën ju të heshtni!

Në qoftë se ato çudira do të shkonin tek sfera e adhurimit dhe të kërkonin të drejtat e tyre, ato do të merrnin prej asaj sfere një përgjigjje si kjo:

"Lidhjet tuaja me ne janë shumë të pakëta dhe ju nuk mund të hyni me lehtësi në sferën tonë; ***Sepse programi ynë është ky; bota është një bujtinë, dhe sa për njeriun, ai qëndron këtu vetëm për një kohë të shkurtër. Ai është një mysafir me shumë detyra dhe në një jetë të shkurtër ai është i detyruar të marrë masat e të përgatisë të gjitha domosdoshmëritë për jetën e tij të përhershme. Prandaj atij i duhet t'i japë përparësi asaj që është më e rëndësishme dhe më e domosdoshme.*** Por shumica prej jush e shohin këtë botë kalimtare nën perden e pakujdesisë, si një banesë të përjetshme, në një formë të punuar me ndjenjat e dashurisë së kësaj bote.

Kështu pjesa e juaj e adhurimit, e cila bazohet në themelet e udhëzimit të së vërtetës dhe mbi të menduarit e Ahiretit, është shumë i vogël. Megjithatë, në qoftë se ka midis jush zejtarë të respektuar dhe artistë e mjeshtër të frymëzuar, të cilët i kryenin punët e tyre thjesht për t'u shërbyer robërve të Zotit xh.sh., ajo është një ibadet i çmueshëm, dhe nëse i bëjnë përpjekjet e tyre për interesat e përgjithshme dhe për qetësinë publike dhe për arritjet në jetën sociale, këto shenja dhe tregues të Kur'anit, sigurisht janë të mjaftueshme për ata njerëz të ndjeshëm, të cilët natyrisht përbëjnë një pakicë, me qëllim që t'i inkurajojnë përpjekjet e tyre dhe të vlerësojnë artin e tyre..."

---

[263] Kur'an, 22: 73

Përgjigja ndaj pyetjes së dytë: Në qoftë se ti thua: *"*Asnjë nga dyshimet e mia nuk ka mbetur tani pas këtyre hetimeve e shqyrtimeve dhe unë vërtetoj se, së bashku me realitetet e tjera, në Kur'an ndodhen aluzione e tregues të çudirave të qytetërimit aktual njerëzor, madje edhe për zhvillime e përparime më të mëdha. Çdo gjë e domosdoshme për lumturinë njerëzore në këtë botë dhe në tjetrën gjendet brenda tij, secila sipas vlerës së saj. Por përse nuk i përmend Kur'ani ato në mënyrë të qartë, me qëllim që mosbesimtarët kokëfortë të detyroheshin që ta pranojnë atë, edhe zemrat tona gjithashtu do të qetësoheshin?"

Përgjigjja: Feja është një provim, një testim i rekomanduar nga Zoti xh.sh. me qëllim që, në arenën e konkursit, shpirtrat e lartë me shpirtrat e ulët të mund të dallohen.

Ashtu siç provohet minerali me zjarr me qëllim që të dallohet diamanti nga qymyri dhe floriri nga dheu, po ashtu janë detyrimet fetare në këtë botë provimi, ato janë sprovim, testim dhe nxitje për konkurrencë derisa të dallohen xhevahiret e çmueshëm nga skoriet në mineralin e aftësive të njeriut.

Meqenëse Kur'ani u shpall në këtë banesë provimi për njeriun që të plotësohet e të përparojë nëpërmjet provimit në arenën e konkursit, sigurisht ai vetëm do të aludojë për ngjarjet e fshehura të së ardhmes lidhur me këtë botë të cilat do të sqarohen në të ardhmen për të gjithë, duke hapur për mendjen një derë në një shkallë që provon argumentin e saj. Në qoftë se ai do t'i përmendte ato ngjarje në mënyrë të qartë, atëherë misteri i rekomandimit do të prishej. Thjesht, ai do të bëhej aq i vetëkuptueshëm si të shkruarit e لَا إِلٰهَ إِلَّا اللّٰهُ ***"La ilahe il-lall-llah"*** qartë me yjet në faqen e qiejve. Atëherë gjithkush do të detyrohej t'i besonte ato me dëshirë apo pa dëshirë. Nuk do të kishte më konkurs, dhe provimi gjithashtu do të humbiste. Një shpirt si qymyri do të qëndronte së bashku me një shpirt si diamanti. [264]

Shkurtazi: Kur'ani Madhështor është i gjithurtë. Ai i jep çdo gjëje një pozitë në lidhje me vlerën e saj. Kështu, qysh prej njëmijë e treqind vjetësh, Kur'ani e shikoi, nga frutat e së padukshmes, përparimin e

[264] Ebu Xhehli i mallkuari dhe Ebu Bekri i Vërteti, do të shfaqeshin të jenë të barabartë, dhe misteri i rekomandimit Hyjnor do të humbiste...

qytetërimit njerëzor, i mbuluar në errësirat e së ardhmes dhe ua tregoi atë njerëzve në një formë më të mirë se sa ajo që shohim e do ta shohim. Domethënë, Kur'ani është fjala e një të Vetmi, i Cili shikon tek të gjitha kohët dhe gjithçka brenda tyre për një moment.

Kështu, ajo është një shkreptimë e mrekullisë së Kur'anit e cila ndriçon në fytyrën e mrekullive të profetëve!..

اَللّٰهُمَّ فَهِّمْنَا اَسْرَارَ الْقُرْآنِ وَ وَفِّقْنَا لِخِدْمَتِهِ فِى كُلِّ آنٍ وَ زَمَانٍ

سُبْحَانَكَ لاَ عِلْمَ لَنَا اِلاَّ مَا عَلَّمْتَنَا اِنَّكَ اَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

رَبَّنَا لاَ تُؤَاخِذْنَا اِنْ نَسِينَا اَوْ اَخْطَاْنَا اَللّٰهُمَّ صَلِّ وَ سَلِّمْ وَ بَارِكْ وَ كَرِّمْ عَلَى سَيِّدِنَا وَ مَوْلَينَا مُحَمَّدٍ عَبْدِكَ وَ نَبِيِّكَ وَ رَسُولِكَ النَّبِيِّ اْلاُمِّيِّ وَ عَلَى آلِهِ وَ اَصْحَابِهِ وَ اَزْوَاجِهِ وَ ذُرِّيَّاتِهِ وَ عَلَى النَّبِيِّينَ وَ الْمُرْسَلِينَ وَ الْمَلٰئِكَةِ الْمُقَرَّبِينَ وَ اْلاَوْلِيَاءِ وَ الصَّالِحِينَ اَفْضَلَ صَلاَةٍ وَ اَزْكَى سَلاَمٍ وَ اَنْمَى بَرَكَاتٍ بِعَدَدِ سُوَرِ الْقُرْآنِ وَ آيَاتِهِ وَ حُرُوفِهِ وَ كَلِمَاتِهِ وَ مَعَانِيهِ وَ اِشَارَاتِهِ وَ رُمُوزِهِ وَ دَلاَلاَتِهِ وَاغْفِرْلَنَا وَارْحَمْنَا وَ الْطُفْ بِنَا يَا اِلهَنَا يَا خَالِقَنَا بِكُلِّ صَلاَةٍ مِنْهَا بِرَحْمَتِكَ يَا اَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ وَ الْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ آمِينَ

O Zot! Na i bëj të kuptueshme misteret e Kur'anit dhe na jep sukses në shërbimin e tij në çdo moment e kohë. "Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."[265] O Zot! Jepi bekime, paqe e nderime shkëlqesisë sonë dhe prijësit tonë, Muhammedit a.s.m., shërbëtorit Tënd, profetit dhe mesazhierit Tënd, lajmëtarit analfabet, familjes së tij, shokëve, bashkëshorteve të tij dhe pasardhësve dhe të gjithë profetëve e mesazhierëve, dhe engjëjve afër Fronit Tënd, dhe evlijave dhe të drejtëve, jepu bekimet më të mira, paqen më të pastër dhe bekimet më të shumta, sa numri i sureve të Kur'anit dhe i vërseteve të tij, i kuptimeve të tij, i treguesve, i shenjave dhe aluzioneve, na jep ne falje, ki mëshirë mbi ne, dhe ji i dhembshur mbi ne, O Zot, o Krijues, sa numri i atyre bekimeve, nëpërmjet mëshirës Tënde, o Mëshiruesi më i madh! Dhe të gjitha lavdërimet i takojnë Zotit, Krijuesit të të gjitha botëve. Amin. Amin.

---

[265] Kur'an, 2: 32

Ky është një "Elif"dhe një "Nokta", -Pikë- të përbëra nga "ene" (uni) dhe "Dher-reja" (grimca).

Kjo Fjalë përbëhet nga dy Qëllime.

Qëllimi i parë lidhet me natyrën dhe rezultatin e "Unit"; dhe Qëllimi i dytë lidhet me lëvizjen e 'Dher-res', -grimcës- së vogël, dhe me detyrat e saj.

QËLLIMI I PARË

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمنِ الرَّحِيمِ

اِنَّا عَرَضْنَا ٱلاَمَانَةَ عَلَى السَّموَاتِ وَٱلاَرْضِ وَالْجبَالِ فَاَبَيْنَ اَنْ يَحْمِلْنَهَا وَاَشْفَقْنَ مِنْهَا وَحَمَلَهَا ٱلاِنْسَانُ اِنَّهُ كَانَ ظَلُومًا جَهُولاً

Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Në të vërtetë, ne ua paraqitëm amanetin (përgjegjësinë, besimin) qiejve, edhe tokës edhe maleve, por ato nuk pranuan ta mbajnë atë dhe kishin frikë prej tij. Por njeriu e mori përsipër atë. Vërtet që ai i bëri keq vetvetes dhe qe i paditur."[266]

Nga thesari i madh i këtij ajeti, ne do të tregojmë një xhevahir të vetëm prej xhevahireve të tij siç vijon:

"Uni" është një përbërës, një prej aspekteve të shumta të Amanetit, nga mbajtja e të cilit, qielli toka dhe malet u zmbrapsën dhe u frikësuan. Në të vërtetë, qysh nga koha e Ademit gjer tani, 'Uni' ka qenë bërthama e një peme të tmerrshme Zekkumi dhe në të njëjtën kohë, e një peme të ndritshme Tuba, e cila ka lëshuar degët rreth e qark botës së njerëzimit. Përpara se të përpiqemi të shpjegojmë këtë të vërtetë të gjerë, ne do të japim një shpjegim me anë të një parathënieje e cila do ta lehtësojë kuptimin e saj të vërtetë, dhe ajo është sa vijon:

---

[266] Kur'an, 33: 72

Uni, ashtu siç është çelësi për Emrat Hyjnorë të cilët janë thesaret e fshehur, po ashtu ai -uni- është çelësi për misterin e mbyllur të universit, ai është një problem i vështirë për t'u zgjidhur, është një enigmë e çuditshme. Por me njohjen e natyrës së 'Unit', zgjidhet ajo enigmë e çuditshme, dhe zbulohet ai mister i çuditshëm; me rolin e tij tregohet enigma e universit dhe shfaqen thesaret e botës së domosdoshme. Ne e kemi diskutuar këtë problem në një trajtesë Arabisht e titulluar: ***"Shemme" '****Një nuhatje prej erës së udhëzimit të Kur'anit',* siç vijon:

Çelësi i botës është në dorën e njeriut dhe i është bashkangjitur nefsit të tij, sepse ndërsa duke qenë në dukje të hapura, dyert e universit në fakt janë të mbyllura. Zoti i Gjithëfuqishëm i ka dhënë njeriut, nëpërmjet një Amaneti -besimi-, një çelës, i quajtur 'Uni', i cili është i tillë që ai i hap të gjitha dyert e botës; Ai i ka dhënë atij 'Unin' enigmatik me të cilin ai mund të zbulojë thesaret e fshehura të Krijuesit të Universit. Por uni, gjithashtu është një enigmë jashtëzakonisht e ngatërruar dhe një mister që është shumë i vështirë për t'u zgjidhur. Në qoftë se natyra e tij e vërtetë dhe qëllimi i krijimit të tij njihen, ashtu siç zgjidhet e zbulohet ai vetë, po ashtu do të zbulohet për ty enigma e universit.

Atëherë, Autori i Gjithurtë i dha njeriut si një amanet, një ego -"Unin"- i cili përfshin tregues dhe shembuj që tregojnë dhe bëjnë të njihen të vërtetat e Atributeve dhe çështjet e shenjta të Hyjnisë së Tij. Domethënë, 'Uni' është një njësi matëse nëpërmjet të cilit mund të njihen Atributet Hyjnore dhe çështjet e Hyjnisë. Por, nuk do të ishte e domosdoshme për një njësi matëse të ketë një ekzistencë reale. Por, ashtu si drejtëzat hipotetike, të supozuara, në gjeometri, një njësi matëse mund të formohet nga hipotezat dhe supozimet. Domethënë nuk është e domosdoshme për 'Unin' që të ketë një ekzistencë reale të vërtetuar nga njohja konkrete dhe nga provat.

Pyetje: Përse është lidhur njohja e Atributeve të Zotit xh.sh. dhe e Emrave të Tij të Bukur me ***'Uni'n'*** e njeriut?

Përgjigjja: Meqenëse një gjë absolute dhe gjithëpërfshirëse nuk ka limit apo fund, asaj nuk mund t'i jepet formë, as nuk mund t'i jepet ndonjë masë, as nuk mund të përcaktohet, dhe kjo për mungesë të një ane të përcaktuar dhe të një forme të saj; prandaj nuk mund të kuptohet e vërteta e esencës së saj.

Për shembull, një dritë e pafundme pa errësirë nuk mund të njihet apo të kapet ekzistenca e saj, veçse në qoftë se ajo do të kufizohej me një errësirë reale ose të imagjinuar. Kështu, meqenëse Atributet e Zotit të Gjithëfuqishëm, Fuqia dhe Emrat e Tij të Bukur si **'El Hakimu', 'Er Rahimu'***, i Gjithurti, Mëshirëploti,* janë gjithëpërfshirës, të pakufishëm, absolutë dhe të pangjashëm, ato nuk mund të përcaktohen çfarë janë ato, nuk mund të njihen dhe nuk mund të perceptohen; prandaj, meqenëse ato nuk kanë limite dhe një fund real, atëherë është e domosdoshme të vendosësh një limit hipotetik e imagjinar për ato Atribute dhe Emra absolutë me qëllim që të jenë një mjet për kuptimin e tyre; dhe këtë e bën 'Uni'. Ai imagjinon në veten e tij një Hyjni të sajuar, një pronësi të supozuar, një fuqi dhe njohje dhe e kufizon me limite të caktuara. Duke bërë kështu, ai vendos një limit imagjinar mbi ato Atribute gjithëpërfshirëse dhe mbi ato Emra Absolutë, dhe thotë, për shembull: "Prej këtu e gjer atje është e imja, dhe pas asaj i takon Atij." Domethënë, ai bën një lloj ndarje të çështjeve. Me njësitë e thjeshta matëse dhe me peshoret e vockla në veten e tij, ai dalëngadalë kupton natyrën e vërtetë të Atributeve. Për shembull, me hyjninë e imagjinuar të cilën e përfytyron në rrethin e pronës së tij, 'Uni' mund të kuptojë Hyjninë e Krijuesit të tij në sferën e mundësive në krijim. Dhe me pronësinë e tij të jashtme të dukshme, ai mund të kuptojë pronësinë e vërtetë të Krijuesit të tij, duke thënë: "Ashtu siç jam unë pronari i kësaj shtëpie, po ashtu Krijuesi është Pronari i këtij universi." Dhe me njohjen e tij të pjesshme ai mund të kuptoje njohjen absolute të Zotit xh.sh., dhe me sasinë e tij të vogël të artit të fituar, ai mund të kuptojë artin origjinal të Krijuesit të Gjithëlavdishëm.

Për shembull, "Uni" thotë**: *"Ashtu siç e ndërtova dhe e organizova unë këtë shtëpi, po ashtu dikush medoemos e ka ndërtuar universin dhe e ka administruar atë",*** dhe kështu me radhë... Me mijëra gjendje të mistershme, atribute dhe aftësi perceptuese, të cilat deri diku bëjnë të njohur dhe tregojnë të gjitha Atributet Hyjnore dhe çështjet e tyre, janë përfshirë tek "Uni".

Domethënë, "Uni është si një pasqyrë, si një njësi matëse, si një instrument zbulimi dhe si një kuptim tregues; duke mos patur kuptim në vetvete, ai tregon kuptimin e të tjerëve. Ai është një fije e vetëdijshme prej litarit të trashë të qënies njerëzore, është një pe i hollë nga thurja e veshjes së esencës së humanizmit, ai është shkronja '*Elif*' nga libri i personazhit të njerëzimit. Ajo shkronjë ka ***"dy fytyra":***

E para e këtyre fytyrave shikon drejt të mirës dhe ekzistencës. Me këtë fytyrë ai është i aftë vetëm për të marrë shkëlqim; ajo pranon çfarë i jepet vetë; ajo nuk mund të krijojë. Kjo fytyrë nuk është aktive, ajo nuk ka aftësi të krijojë.

Fytyra tjetër e tij shikon drejtë së keqes dhe shkon për tek mosekzistenca. Ajo fytyrë është aktive, ajo ka fuqinë për të vepruar. Për më tepër, natyra reale e "Unit" është treguese; ajo tregon kuptimin e gjërave përveç vetes. Hyjnia e tij është imagjinare. Ekzistenca e tij është aq e dobët dhe aq e hollë, saqë ajo vetë nuk mund të mbajë apo mbështesë asgjë fare. Përkundrazi, ajo është veçse një lloj peshoreje ose matëse, si një termometër ose barometër, që tregon shkallët dhe sasitë e gjërave, ajo është si një masë që bën të njohur Atributet Absolute gjithëpërfshirëse dhe të pakufishme të Ekzistuesit të Domosdoshëm. Kështu, ai i cili e njeh natyrën e "Unit, të vetvetes në këtë mënyrë dhe kupton e vepron në përputhje me të, ai përfshihet brenda sihariqeve të Fjalës së Zotit xh.sh.:

قَدْ اَفْلَحَ مَنْ زَكَّيهَا *"Vërtet që do të ngadhënjejë ai i cili e pastron vetveten."*[267]

Ai vërtetë e ka përmbushur amanetin dhe nëpërmjet teleskopit të unit të tij, ai njeh se cili është realiteti i universit dhe çfarë detyrash po kryen ai. Dhe kur ai fiton njohuri rreth universit, shikon se uni i tij e vërteton. Kjo njohuri do të mbetet si dritë e urtësi për të dhe nuk do të transformohet në errësirë e kotësi. Kur "Uni e përmbush detyrën e tij në këtë mënyrë, ai e braktis hyjninë e tij imagjinare dhe pronësinë e supozuar të cilat janë thjesht njësi matëse dhe jo tjetër, dhe ia autorizon pronësinë vetëm All-llahut duke thënë:

لَهُ الْمُلْكُ وَ لَهُ الْحَمْدُ وَ لَهُ الْحُكْمُ وَ اِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

"I Tij është sovraniteti dhe Atij i përket lavdërimi, i Tij është gjykimi dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni." Ai arrin adhurimin e vërtetë dhe ngjitet tek *"Rangu i Modelit më të bukur"*.

Por në qoftë se uni e harron urtësinë e krijimit të tij dhe nuk ngjitet tek rangu i Modelit më të bukur, dhe braktis detyrën e tij të natyrshme, e shikon vetveten vetëm në dritën e kuptimit të tij emëror, formal dhe

[267] Kur'an, 91: 9

të dukshëm; në qoftë se beson se ai e ka në pronësi vetveten, atëherë ai e ka tradhtuar amanetin dhe përfshihet brenda paralajmërimit Hyjnor:

وَ قَدْ خَابَ مَنْ دَسَّيهَا *"Dhe vërtetë që dështon ai i cili e prish vetveten."*[268]

Kështu frika e qiejve, e tokës dhe e maleve nga mbajtja e Amanetit -besimit- dhe frikësimi i tyre nga shirku hipotetik i supozuar është vetëm nga ky aspekt i Unit, i cili shkakton të gjitha llojet e shirkut (të përshkruarit ortakë me All-llahun xh.sh.) dhe të gjitha të këqijat dhe ç'udhëzimet.

Po, ***Uni***, megjithëse është një ***elif*** i hollë, një pe dhe një vizë hipotetike e supozuar, ama në qoftë se nuk njihet natyra e tij, ai mugullon në fshehtësi, ashtu siç mugullon fara në tokë dhe gradualisht zmadhohet, derisa depërton e futet tek të gjitha pjesët e qënies njerëzore dhe e gëlltit atë ashtu si një kuçedër me përmasa vigane, atëherë ai njeri i tëri me të gjitha aftësitë e tij të holla do të bëhej thjesht "Uni".

Pastaj 'Uni' i llojit njerëzor i jep forcë 'Unit' të individit, nëpërmjet racializmit njerëzor dhe racializmit kombëtar. 'Uni' duke fituar mbështetje nga 'Uni' i llojit njerëzor bëhet si shejtan dhe kundërshton urdhrat e Krijuesit të Gjithëlavdishëm. Pastaj, duke e përdorur vetveten si një masë jardi, ai e krahason gjithkënd, madje gjithçka me vetveten; ai e ndan mbretërinë e Zotit të Gjithëfuqishëm ndërmjet tyre dhe shkaqeve të tjera. Ai bie në shirk -në të përshkruarit ortakë All-llahut- në një shkallë të gjerë, duke treguar kuptimin e vërsetit Kur'anor:

اِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ

"T'i përshkruash ortakë All-llahut është me të vërtetë padrejtësia dhe krimi më i madh,"[269] sepse ashtu si një njeri i cili vjedh dyzet dinarë nga dinari i shtetit që patjetër duhet t'i kënaqë shokët e tij që janë të pranishëm me të, duke i dhënë secilit prej tyre një monedhë me qëllim që të justifikojë vjedhjen... po kështu njeriu i cili thotë: "Unë jam Pronari i vetes sime", duhet patjetër të thotë e të besojë se, "çdo gjë është pronare e vetvetes."

---

[268] Kur'an, 91: 10

[269] Kur'an, 31: 13

Kështu, në këtë pozitë tradhtare ndaj Amanetit, 'Uni' është në një injorancë absolute. Madje edhe sikur ai të njihte me mijëra degë të shkencës, me injorancën e tij të përbërë ai është më injoranti, sepse kur shqisat e tij dhe mendimet fitojnë dritat e njohjes së universit, ato drita shuhen për shkak se një 'Uni' i tillë nuk gjen ndonjë material brenda vetvetes me të cilin t'i vërtetojë, t'i ndriçojë dhe t'i përjetësojë ato. Prandaj shuhen të gjitha ato njohje, dhe bëhen errësirë e dendur, pasi gjithçka që erdhi tek ai ngjyroset me ngjyrën e errët e të zymtë të vetes së tij; saqë madje sikur t'i vinte atij urtësi e pastër, urtësia do të merrte formën e një kotësie absolute brenda 'Unit', sepse ngjyra e 'Unit' që është në këtë gjendje, është shirku, është ateizmi dhe mohimi i Zotit të Gjithëfuqishëm.

Në qoftë se i gjithë universi do të ishte plotë shenja të ndritshme, një pikë e errët që gjendet tek 'Uni' i fsheh ato nga shikimi, dhe do t'i eklipsonte të gjitha ato drita sikur të ishin të shuara. Natyra e njeriut dhe e 'Unit' brenda natyrës së tij është shpjeguar qartë dhe me hollësi tek Fjala e Njëmbëdhjetë, të cilat tregojnë diçka tjetër matanë vetvetes. Ato janë treguar të jenë shkalla më e ndjeshme dhe masa më e saktë, një indeks dhe një hartë e plotë, një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe një kalendar e ditar i përshtatshëm për universin. Meqenëse ne e konsiderojmë si të mjaftueshëm shpjegimin në atë Fjalë, atëherë kush dëshiron le t'i referohet asaj, dhe kështu ne e presim shkurt dhe i japim fund parathënies këtu.

Në qoftë se ti e ke kuptuar parathënien, eja të hyjmë së bashku pikërisht tek e vërteta. Merre në konsideratë këtë: Në botën e njerëzimit, nga koha e Ademit gjer tani, dy rryma të mëdha, dy linja mendimi, kanë qenë gjithmonë dhe kështu do të vazhdojnë. Si dy pemë të mëdha, ato kanë shpërndarë degët e tyre në të gjitha drejtimet dhe në çdo klasë të njerëzimit. Njëra nga ato është linja e profetësisë dhe e fesë dhe tjetra është ajo e filozofisë dhe e formave të ndryshme të saj. Sa herë që ato dy linja kanë qenë në përputhje mendimesh me njëra-tjetrën, në harmoni e të bashkuara, domethënë, në qoftë se linja e filozofisë, duke iu bashkuar linjës së fesë ka qenë e bindur dhe në shërbim të saj, bota e humanizmit ka përjetuar lumturi dhe një jetë të ndritshme shoqërore. Ndërsa, kur ato kanë qenë të ndara, e gjithë drita dhe e mira është grumbulluar tek linja e profetësisë dhe e fesë, dhe të këqijat dhe ç'udhëzimet u grumbulluan rreth linjës së filozofisë.

Tani, le të gjejmë origjinën dhe themelet e atyre dy linjave.

Linja e filozofisë që nuk i bindet linjës së fesë, duke marrë formën e një peme Zekkumi, i përhap errësirat e shirkut, të idhujtarisë dhe përhap ç'udhëzimet në të gjitha anët. Madje edhe në degën e fuqisë së mendjes, ajo prodhon frutin e Ateizmit, Materializmit dhe të Natyralizmit për shkatërrimin e intelektit njerëzor.

Dhe në degën e fuqisë së pasionit ajo derdh mbi kokën e njerëzimit frutat e tiranive të Nemrudit, Faraonit dhe Sheddadit.[270] Dhe në degën e fuqisë së orekseve e dëshirave shtazore, ajo rrit dhe mban frutat e hyjnive, idhujve dhe të atyre që pretendojnë hyjni. Dhe përbri kësaj peme të ndyrë, pemës së Zekkumit, e ka origjinën edhe pema Tuba e Adhurimit, ajo e linjës së profetësisë, këto janë në dy fytyrat e 'Unit'. Degët e bekuara të linjës së profetësisë në kopshtin e globit tokësor janë si më poshtë vijon:

Në degën e intelektit ajo ka rritur frutet e profetëve, të mesazhierëve, evlijave dhe të vërtetëve. Në degën e fuqisë së shtytjes, ajo ka prodhuar mbretër engjëllorë dhe sundimtarë të drejtë. Dhe në degët e Fuqisë së tërheqjes, ajo ka prodhuar njerëz me karakter të mirë, modestë, me sjellje të mira, bujarë dhe zemërbutë. Kështu, linja e profetësisë ka treguar se si njerëzimi është fruti më i përkryer i universit.

Dhe kështu origjina e kësaj peme të bekuar dhe origjina e asaj peme të ndyrë janë dy anët e unit. Ne do t'i shpjegojmë të dy fytyrat e 'Unit' si rrënja dhe boshti dhe si bërthama kryesore e atyre dy pemëve: Domethënë, Profetësia kalon duke marrë njërën anë të '*Unit'*, dhe filozofia afrohet duke marrë anën tjetër të '*Unit'*, duke bërë që ata të ndahen në mendime.

---

[270] Po, në të vërtetë, ishte moçali i filozofisë Natyraliste që bëri të lindin idhujt dhe vendosi hyjnitë në kokat e grekëve të lashtë, që ushqyen dhe rritën Nemrudët dhe Faraonët. Dhe ishte përsëri e njëjta folozofi Natyraliste që prodhoi filozofitë e Egjiptit të lashtë dhe të Babilonisë, të cilat ose arritën shkallën e magjisë, ose meqenëse ato u përfaqësuan nga elita, u konsideruan të jenë magji nga njerëzit në përgjithësi. Po, sigurisht, në qoftë se njeriu nuk do ta perceptonte dritën e Zotit të Gjithëfuqishëm për shkak të perdes së natyrës, ai do t'ia atribuonte Hyjninë çdo gjëje, dhe kështu do t'i shkaktonte vetes së tij veçse shqetësim.

Fytyra e parë, e cila është fytyra e Profetësisë:

Ajo është origjina e adhurimit të pastër dhe të vërtetë. Domethënë, 'Uni' e di vetveten se është një rob i bindur ndaj Krijuesit të tij. Ai e kupton se ai i shërben dikujt tjetër, dhe jo vetes. Esenca e tij ka vetëm një kuptim tregues. Domethënë, kupton se ai mban dhe përcjell kuptimin e një tjetri. Ekzistenca e tij është e varur, domethënë, ai beson se ekzistenca e tij është vetëm për shkak të Ekzistencës së një tjetri, dhe se vazhdimësia e erzistencës së tij, është vetëm për shkak të krijueshmërisë së tij nga Ai tjetri.

Pronësia e tij është e rreme, domethënë ai e di se me lejen e pronarit të tij, ai ka një pronësi të jashtme e të përkohshme. Realiteti i tij është si një hije; domethënë, një hije e mundshme dhe e dobët që shfaq manifestimin e një realiteti të vërtetë e të domosdoshëm. Sa për funksionin e tij, duke qenë një masë dhe një peshore për Atributet dhe çështjet e Krijuesit të tij, ai është një shërbim i vetëdijshëm.

Dhe kështu, në këtë anë e shikuan Unin profetët, të pastërtit dhe evlijatë, të cilët ishin nga linja e profetësisë. Ata e panë atë me këtë vështrim dhe e kuptuan të vërtetën. Ata ia dorëzuan të gjithë pronën, Pronarit të Vetëm të gjithësisë dhe dolën me përfundimin se Pronari i Gjithëlavdishëm nuk ka as ortakë e as të ngjashëm, as në sovranitetin e Tij, as në Hyjninë e Tij, as në qënien e Tij Perëndi. Ai nuk ka nevojë për ndihmës apo asistent. Çelësi i të gjitha gjërave është në Dorën e Tij. Ai është i Gjithëfuqishëm Absolut mbi gjithçka. Ata gjithashtu përfunduan se shkaqet janë veçse një perde e jashtme në dukje, të cilat tregojnë Fuqinë e Tij dhe madhështinë e Tij. Sa për Natyrën, ajo është vetëm se; Sheriati i natyrshëm i Tij, një koleksion i ligjeve të Tij që veprojnë në univers dhe mënyra me të cilën Ai demonstron Fuqinë e Tij.

Kështu, kjo fytyrë e ndritshme, dritëdhënëse dhe e bukur është si një bërthamë e gjallë dhe kuptimplote nga e cila Krijuesi i Gjithë-lavdishëm ka krijuar pemën Tuba të adhurimit, degët e bekuara të së Cilës kanë zbukuruar me fruta të ndritshëm të gjitha pjesët e botës së humanizmit. Duke larguar errësirën e të gjithë të shkuarës, ajo tregon se ajo kohë e gjatë e shkuar nuk është një vend moekzistence, dhe as një varrezë e madhe, ashtu siç e shikon filozofia, por ajo është një kopsht rrezatues dhe një vend drite për shpirtrat e ndritshëm të cilët e kanë lënë këtë botë, duke i hequr peshat e tyre të rënda dhe qëndrojnë të lirë. Është një ngjitje e ndritur me shumë shkelëza dhe një orbitë

dritash për shpërnguljen e shpirtrave me qëllim që ato të kapërcejnë e të kalojnë tek Ahireti, tek e ardhmja e lulëzuar dhe tek lumturia e përjetshme.

Fytyra e dytë:

Ajo përfaqësohet nga filozofia. Dhe sa për filozofinë, ajo e shikon 'Unin' që nuk ka kuptim tjetër përveç vetvetes së tij. Domethënë, ajo deklaron se 'Uni' tregon vetëm veten e tij, se kuptimi i tij është në veten e tij. Ajo mendon se 'Uni' punon thjesht për llogari të vetes së tij. Ajo e shikon ekzistencën e tij si të domosdoshme dhe esenciale, domethënë, ajo thotë se Ai ekziston në vetvete nga vetvetja. Ajo gabimisht pretendon se 'Uni' e ka vetë në pronësi jetën e vet dhe se ai është Pronari i vërtetë në sferën e tij të vendosjes e të drejtimit. Ajo e supozon atë si një të vërtetë të qëndrueshme. Dhe ajo e konsideron detyrën e 'Unit' të jetë plotësimi i vetes, gjë e cila buron nga dashuria për vetveten, e kështu me radhë...

Po ashtu, filozofitë i kanë ndërtuar metodat e tyre të mendimit mbi themele të tilla të prishura. Ne kemi dhënë prova të sigurta në trajtesat tona të tjera, dhe veçanërisht tek ***"Fjalët"***, dhe sidomos tek Fjalët e Dymbëdhjeta dhe e Njëzet e Pesta, se sa të pabaza dhe sa të kalbura janë këto themele.

Madje edhe njerëzit si ***Platoni***, ***Aristoteli***, ***Ibn Sina*** dhe ***Farabiu***, të cilët ishin përfaqësuesit më të shquar dhe autoritetet e linjës së filozofisë, thanë se "Qëllimi përfundimtar i plotësimit të humanizmit është përngjasimi me Qënien e Domosdoshme!, domethënë, me Krijuesin xh.sh.." Ata kështu dhanë një gjykim në mënyrën e Faraonit, duke e kamxhikuar egoizmin dhe duke e lejuar politeizmin të vrapojë i lirë nëpër luginat e shirkut e të ç'udhëzimit; ata shtruan rrugën për mënyra të ndryshme të shirkut, të adhurimit të shkaqeve, të idhujtarisë, të natyrës dhe të yjeve. Ata i mbyllën dyert e pafuqisë, dobësisë, varfërisë, nevojës, mangësisë dhe të paplotësisë, të cilat janë vetjake të brendshme -thelbësore- për qëniet njerëzore, dhe kështu bllokuan rrugën për adhurimin e Zotit xh.sh... Duke qenë të zhytur në Natyralizëm dhe duke qenë krejtësisht të paaftë të dalin nga shirku, ata qenë të pamundur të gjejnë derën e gjerë të falënderimeve...

Nga ana tjetër, Linja e Profetësisë konsideroi, në mënyrën e një adhuruesi, se qëllimi i Humanizmit dhe detyra e qënieve njerëzore

është të brumosen me moralet e dhëna nga Zoti xh.sh. dhe me sjelljet e mira dhe, duke njohur pafuqinë e tyre, të kërkojnë strehim tek Fuqia Hyjnore.. dhe duke parë dobësinë e tyre të mbështeten tek Fuqia Hyjnore.. duke kuptuar varfërinë e tyre të besojnë tek mëshira Hyjnore.. duke shikuar nevojën e tyre të kërkojnë ndihmë nga pasuria Hyjnore.. duke parë gabimet e tyre të kërkojnë falje nëpërmjet faljes Hyjnore.. dhe duke kuptuar mangësinë e tyre të jenë lavdërues të Plotësimit Hyjnor..

Kështu, meqenëse filozofia nuk i bindet linjës së fesë, ajo ka humbur rrugën e saj, dhe 'Uni' ka marrë frerët në duart e tij dhe nxiton e rend në të gjitha llojet e ç'udhëzimit. Dhe kështu mbiu pema e Zekkumit në majën e kësaj ane të fytyrës së 'Unit' e cila gllabëroi më shumë se gjysmën e njerëzimit. Kështu, në degën e fuqisë së dëshirave shtazore të asaj peme, frutat që ajo i ka paraqitur njerëzimit, janë idhujt dhe perënditë, sepse sipas parimeve të filozofisë, forca është miratuar si parim themelor, si: "Forca është e drejta" -arsyeja është me të fortin. Madje filozofia thotë: "E gjithë fuqia është për më të fortin," 'fituesi i merr të gjitha', dhe "në forcë është e drejta", [271] ajo i ka dhënë mbështetje morale tiranisë, ka brohoritur shtypjen në kuptim, ka inkurajuar despotët dhe i ka nxitur shtypësit për të pretenduar hyjninë.

Gjithashtu, duke e uzurpuar bukurinë në veprat e artit dhe hijeshinë në finesë, në dekorim e zbukurim, dhe duke ua atribuuar ato vetë veprave të artit dhe dekorimit të tyre, dhe duke mos i lidhur ato me shfaqjen e Bukurisë së shenjtë e të pastër të Krijuesit dhe Skalitësit Madhështor, ajo thotë: "Sa e bukur është kjo", në vend të "Sa bukur është bërë kjo", duke e bërë kështu secilën nga ato bukuri një idhull të denjë për adhurim. Për më tepër, ajo admiron shfaqjet e famës dhe bukurinë e jashtme prej hipokrizie dhe namin e mburrjen, ajo mund t'i shitet cilitdo, ajo u ka brohoritur hipokritëve dhe i ka shtyrë ata që të vazhdojnë në padrejtësinë e tyre duke bërë nga shembujt e idhujve, monumente njerëzish, për adhuruesit e tyre. [272]

---

[271] Ndërsa parimi i profetësisë thotë: 'Forca është me të drejtën', 'e drejta nuk është në forcë'. Ajo kështu ndalon tiraninë dhe siguron drejtësinë.

[272] Domethënë, me qëllim që të shfaqen të dëshirueshëm për adhuruesit e tyre dhe të tërheqin vëmendjen e tyre, ata njerëz që u ngjasojnë idhujve, shfaqin nëpërmjet mburrjes së tyre prej hipokrizie, pozita që i ngjasojnë adhurimit.

Në degën e fuqisë së pasionit të asaj peme, ajo ka rritur frutat e Nemrudëve, Faraonëve dhe Sheddadëve, të mëdhenj e të vegjël, duke sunduar mbi njerëzimin e mjerë. Në degën e fuqisë së intelektit, ajo ka prodhuar fruta si Ateizmin, Materializmin dhe Natyralizmin në mendjen e humanizmit, dhe e ka ngatërruar, shpërndarë dhe e ka bërë atë një mijë copash..

Tani, me qëllim që të ndriçohet kjo e vërtetë, ne do të krahasojmë rezultatet të cilat kanë lindur nga themelet e shëndosha të linjës së profetësisë me ato që burojnë nga themelet e kalbura të rrugës së filozofisë, dhe do të përmendim tre ose katër shembuj prej mijëra krahasimesh.

Shembulli i parë: Sipas rregullit të: تَخَلَّقُوا بِاَخْلاَقِ اللّٰهِ *"Brumosuni me moralet e dhëna nga Zoti xh.sh.",* i cili është njëri nga parimet e linjës së profetësisë lidhur me jetën individuale, ndodhet instruksioni:

"Dallohuni nga etika me etikën dhe me moralet e dhëna nga Zoti xh.sh. dhe kthehuni drejt Zotit të Gjithëfuqishëm me për-ulësi duke pranuar pafuqinë tuaj, varfërinë dhe mangësinë, dhe kështu jini robër të sinqertë në prezencën e Tij." Atëherë ku është ky parim në krahasimin me rregullin egoist të filozofisë i cili është: "Përpiqu të imitosh Ekzistuesin e Vetëm të domosdoshëm!" që u bë synimi i njerëzimit për plotësim, dhe ku është esenca e humanizmit e cila është brumosur me pafuqi të pafundme, me dobësi, me varfëri dhe nevojë, dhe ku është Esenca e Ekzistuesit të vetëm të domosdoshëm i cili është i Gjithëfuqishëm pafundësisht, i gjithëpushtetshëm, i vetëmjaftueshëm, dhe absolutisht pa asnjë nevojë!...

Shembulli i dytë: Midis parimeve të linjës së profetësisë lidhur me jetën shoqërore janë ato të ndihmës së ndërsjellë -reciproke-, shpirtmadhësia dhe bujaria.

Ky parim sundon në të gjithë universin, duke filluar nga Dielli dhe Hëna dhe duke përfunduar tek bimët dhe kafshët, sepse ti, për shembull, i shikon bimët t'u japin ndihmë kafshëve, dhe kafshët u japin ndihmë qënieve njerëzore, madje edhe grimcat e ushqimit mbështesin qelizat e trupit. Ndërsa midis parimeve të linjës së filozofisë lidhur me jetën sociale është parimi i "konfliktit", i cili buron nga keqpërdorimi i natyrave dhe i prirjeve të tyre të bashkëlindura nga

një numër tiranësh, nga njerëz brutalë e mizorë dhe nga njerëz të egër e barbarë, madje aq shumë është zhytur filozofia në humbjen e saj, saqë ajo e ka marrë këtë parimin e "konfliktit" si themelor dhe të përgjithshëm, dhe si e çmendur ka deklaruar: "Jeta është një konflikt."

Shembulli i tretë: Një nga rezultatet e vlefshme dhe nga parimet e lartësuara të linjës së profetësisë lidhur me Unitetin Hyjnor është:

اَلْوَاحِدُ لاَ يَصْدُرُ اِلاَّ عَنِ الْوَاحِدِ *"Në qoftë se një gjë ka unitet, ajo duhet të burojë vetëm nga Një i vetëm."* ***Domethënë, meqenëse çdo gjë në vetvete dhe tek të gjitha gjërat kolektivisht ka unitet, duhet patjetër që ato të jenë nga krijimi i një Qënieje të Vetme."***

Ndërsa njëri nga parimet e filozofisë së lashtë dhe nga besimi i saj është: اَلْوَاحِدُ لاَ يَصْدُرُ عَنْهُ اِلاَّ الْوَاحِدُ *"Nga njëri del (buron) vetëm një."* Domethënë, "Nga një person, vetëm një gjë e vetme mund të burojë, pastaj çdo gjë tjetër buron prej tij nëpërmjet ndërmjetësve." Ky parim i gabuar e mashtrues i filozofisë i cili është i njollosur nga shirku – politeizmi- e paraqet edhe të Vetëmjaftueshmin Absolut dhe të Gjithë-fuqishmin Absolut sikur është në nevojë për ndërmjetësuesit e pafuqishëm, si dhe u jep të gjitha shkaqeve dhe ndërmjetësuesve një lloj ortakërie në Hyjninë e Tij. Ajo i atribuon Krijuesit të Gjithëlavdishëm titullin e "Motorit parësor" **-Mendjes së parë-,** titull ky që në fakt tregon statusin e krijesës. Dhe, për më tepër, ajo ua ndan pjesën tjetër të sovranitetit të Tij shkaqeve dhe ndërmjetësve, dhe kështu ajo hap rrugën e shirkut në mënyrën më gjithëpërfshirëse. Në qoftë se iluministët -ishrakijunët-, të cilët ishin filozofë të shquar, do të thonin absurditete e fjalë boshe si kjo, ju mund ta imagjinoni se sa shumë absurde do të ishte ajo çfarë thonë filozofët më të ulët, si materialistët dhe natyralistët.

Shembulli i katërt: Sipas kuptimit të:

وَ اِنْ مِنْ شَيْءٍ اِلاَّ يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

"Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij"[273], i cili është njëri nga parimet e urta të profetësisë, ***"Në qoftë se qëllimi dhe urtësia e çdo gjëje,***

[273] Kur'an, 17: 44

dhe sidomos e çdo gjëje të gjallë, ka një aspekt i cili shikon tek vetë qënia, atëherë qëllimet që kanë të bëjnë me Autorin dhe shembujt e urtësisë të cilët shikojnë Krijuesin e tyre duhet të jenë me mijëra. Çdo gjë, e madje një frut i vetëm, për shembull, ka aq shumë urtësi dhe aq shumë qëllime, aq sa të gjithë frutat e një peme.”

Ky parim, i cili është një e vërtetë e pastër, rrjedh nga bashkimi i njërës prej formave të filozofisë me linjën e profetësisë. Ndërsa parimet absurde të një filozofie mashtruese që nuk i janë bashkuar kësaj linje, thonë: “Urtësia e krijimit të çdo qënie të gjallë dhe dobia e saj shikojnë tek vetvetja, ose lidhen me dobitë për njerëzimin” . Kështu duke konsideruar në të një kotësi shumë të pakuptimtë, filozofia ia bashkangjit një qëllim, një frut të vockël, një pemeje aq të madhe sa një mal.

Për shkak se kjo e vërtetë është shpjeguar deri diku tek e Vërteta e Dhjetë e Fjalës së Dhjetë, dhe disa pjesë janë përmendur deri diku në një trajtesë të titulluar ***“El-levamiu”-Rrezëllimat-***[274]***,*** ne e kemi prerë shkurt atë këtu. Megjithatë, ju mund t’i zgjeroni në mijëra këto katër shembuj.

Për shkak të këtyre themeleve të kalbura dhe rezultateve shkatërrimtare të filozofisë, njerëzit gjenialë midis filozofëve muslimanë si *Ibnu Sina* dhe *Farabiu* u joshën nga shkëlqimi i saj i jashtëm dhe u mashtruan në zgjedhjen e kësaj rruge, kështu ata mezi fituan vetëm rangun e një besimtari të zakonshëm. Madje Imam Gazali, Huxh-xhetul Islam -*Prova e Islamit*- nuk ua dha atyre as këtë rang të ulët.

Gjithashtu, me në krye mu’tezilitët, të cilët ishin midis dijetarëve më të shquar të shkencave Islame, duke u ngashënjyer e tërhequr nga shkëlqimi i jashtëm i filozofisë, dhe duke u lidhur shumë ngushtë me të, e pretenduan mendjen të ishte e vetëmjaftueshme. Për shkak të kësaj ata mundën të arrinin vetëm rangun e një besimtari të devijuar e novator.

Për më tepër, për shkak se ato figura të shquara të letërsisë së Islamit, si *Abu al Ala el Maariu*, i cili ishte me famë për pesimizmin e tij, dhe *Umer Hajjami*, i cili u karakterizua nga vajtimi i tij i mjerueshëm, morën kënaqësinë tek filozofia ledhatuese për nefset e tyre urdhërues për të liga, dhe kështu ata morën kundërshtimet dhe

---

[274] Kjo trajtesa e El-levamiu, “Lemeat” është përfshirë në fund të koleksionit të “Fjalëve” me sugjerimin e Hazreti ustadhit tonë . (Studentët e tij në shërbim)

qëndrimet dënuese, qortuese e përbuzëse si dhe goditjet frenuese e ndëshkuese prej njerëzve të së vërtetës e të plotësimit, të cilët u thanë atyre: "Ju jeni të pafytyrë, ju po hyni në pafesi, ju po përgatisni mosbesimtarë."

Një rezultat tjetër i themeleve të kalbura të linjës së filozofisë është se, megjithëse 'Uni' ka në vetvete vetëm një esencë të dobët, sikur të ishte ajër ose avull, mirëpo për shkak se qëndrimi fatzi i filozofisë e shikon atë si të lidhur vetëm me vetveten, ai lëngëzohet, pra ai 'Uni' si avull sikur bëhet lëng; dhe atëherë, për shkak të familjaritetit, zakonit të tij dhe preokupimit me materializmin, ai ngurtësohet e fortësohet; pastaj, nëpërmjet neglizhencës dhe mohimit, ai egoizëm -*Uni*- ngrin.

Pastaj, nëpërmjet kryengritjes e mosbindjes ndaj urdhërave të Zotit xh.sh., ai bëhet, opak -i errët, i patejdukshëm- duke humbur tejdukshmërinë e tij; pastaj gradualisht bëhet më i dendur e më i trashë derisa mbështjell e gëlltit pronarin e tij. Më vonë ai bëhet i fryrë dhe i zgjeruar me mendimet e njerëzimit.

Pastaj duke supozuar pjesën tjetër të humanizmit, dhe madje edhe shkaqet, të jenë si vetja e tij, ndonëse ato nuk e pranojnë këtë dhe e mohojnë, ai u jep secilës prej tyre statusin e një Faraoni. Atëherë tek kjo pikë ai merr pozitën e tij duke kundërshtuar urdhrat e Zotit të Gjithëlavdishëm, dhe thotë:

مَنْ يُحْيِى الْعِظَامَ وَ هِىَ رَمِيمٌ

"Kush do t'u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur?"[275]

Dhe si një sfidë, e akuzon të Gjithëfuqishmin Absolut për pafuqi. Ai madje ul e zhvleftëson Atributet e Krijuesit të Gjithëlavdishëm. Ai ose i mohon, ose i ndryshon ose i shtrembëron ato që nuk u përshtaten interesave të tij dhe çfarë nuk e kënaq nefsin e tij si Faraoni.

Për ta përmbledhur: Një grup filozofësh duke e quajtur Zotin e Gjithëfuqishëm: "i Vetëdomosdoshmi", i mohuan Atij zgjedhjen dhe dëshirën. Ata mohuan dëshminë e pafundme të të gjithë universit, e

[275] Kur'an, 36: 78

cila provon se Ai ka zgjedhje. ***Subhanall-llah****! Sa çudi*! Megjithëse të gjitha qëniet në univers duke filluar nga grimca më e vogël deri tek dielli, tregojnë se Krijuesi ka zgjedhje, secila me individualitetin e saj të caktuar, rregullin, urtësinë dhe masën, kjo filozofi e verbër refuzoi për ta shikuar Atë.

Për më tepër, një grup tjetër filozofësh tha: Njohuria Hyjnore nuk është lidhur me çështjet e pjesshme të parëndësishme dhe mohuan njohurinë Hyjnore gjithëpërfshirëse dhe madhështore. Duke folur kështu ata hodhën poshtë dëshminë e vërtetë të të gjitha qënieve. Përveç kësaj, duke ia atribuuar pasojat shkaqeve, filozofia i jep dorës së Natyrës aftësinë krijuese.

Ashtu siç është provuar në mënyrë të sigurt në Fjalën e Njëzet e Dytë, meqenëse filozofia nuk e shikon vulën e ndritshme mbi gjithçka që tregon Krijuesin e të gjitha gjërave, dhe e pretendon natyrën të jetë Krijuesi, e cila është e pafuqishme, e pajetë, e pavetëdijshme dhe e verbër, dhe fuqia e jashtme e së cilës është në të dyja duart e rastësisë dhe të forcës, të cilat gjithashtu janë të verbra; ajo ia atribuon Natyrës disa qënie, kur çdonjëra prej të cilave shpreh mijëra shembuj të urtësisë së lartë dhe është si një mesazh i Krijuesit Madhështor.

Përveç kësaj, filozofët nuk e gjetën derën, nuk u drejtuan për tek Ringjallja dhe Bota tjetër, të cilat, siç është provuar në Fjalën e Dhjetë, Zoti i Gjithëfuqishëm, me të gjithë Emrat e Tij, dhe Universi me të gjitha të vërtetat e tij, dhe linja e profetësisë me të gjitha verifikimet e saj, dhe librat e shpallur me të gjitha vërsetet e tyre, i demonstrojnë. Prandaj filozofia e mohoi ringjalljen dhe pretendoi përjetësinë e shpirtrave.

Ju mund të nxirrni si përfundim të deduktueshëm prej këtyre besëtytnive se cilat do të ishin pikëpamjet e tyre mbi çështje të tjera. Po, sikur shejtanët i kanë rrëmbyer me forcë mendjet e filozofëve ateistë dhe sikur i kanë marrë me sqepin e 'Unit' dhe me kthetrat e tij, dhe i kanë hedhur në luginat e ç'udhëzimit.

Kështu 'Uni' në botën e vogël -që është njeriu-, është si Natyra në Botën e madhe. Që të dyja ato janë idhuj.

فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنْ بِاللّٰهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى لاَ انْفِصَامَ لَهَا وَاللّٰهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

"Kushdo që mohon Tagutin dhe beson në All-llahun, atëherë ai ka rrokur mbajtësin më të sigurt që nuk thyhet kurrë. Dhe All-llahu është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri"[276]

Është e përshtatshme të përmendim këtu kuptimin e një ngjarjeje të sajuar, të cilën e përshkrova, çka i ngjason një hartimi në Trajtesën ***"El-levamiu-Rrezëllimat-"*** si një udhëtim imagjinar i cili do të ndriçojë të vërtetën e lartpërmendur.

Tetë vjet përpara shkrimit të kësaj trajtese, në Stamboll gjatë muajit të Ramazanit, kur Saidi i Vjetër gati po shndërrohej në Said të Ri, po interesohej me studimin e filozofisë, ndërsa po shqyrtoja tre rrugët që tregohen në fundin e Sures el-Fatiha.

صِرَاطَ الَّذِينَ اَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَ لاَ الضَّالِّينَ

"Në rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mirësinë Tënde, jo në rrugën e atyre që merituan zemërimin Tënd mbi vete, dhe as në (rrugën e) atyre të cilët u humbën."[277]

Unë shikova diçka që i ngjasonte një ëndrre ose vizioni, ose një ngjarjeje imagjinare, si më poshtë vijon:

Unë e pashë veten në një shkretëtirë të madhe. Një shtresë e errët, dëshpëruese dhe mbytëse reje kishte mbuluar gjithë sipërfaqen e tokës. Nuk kishte as fllad, as dritë dhe as ujë... dhe nuk gjendej asnjëra prej tyre. Unë imagjinova se gjithandej kishte plot kuçedra, përbindësha dhe krijesa të tmerrshme e të rrezikshme.

Në zemrën time m'u shfaq se në anën tjetër të kësaj toke duhet të kishte dritë, fllad dhe ujë. Ishte e domosdoshme për të shkuar atje. Ndërkohë kuptova se po shtyhesha për atje në mënyrë të pavullnetshme. U futa në një shpellë nën tokë, e cila i ngjasonte një tuneli nën male dhe dalëngadalë eca në brendësi të tokës. Unë shikova se shumë njerëz kishin kaluar në këtë rrugë nëntokësore para meje, por pa e plotësuar udhëtimin, pasi mbetën në vendet e tyre të mbytur. Unë shikova gjurmët e këmbëve të tyre, një herë unë dëgjova disa nga zërat e tyre dhe pastaj ato zëra u ndërprenë.

---

[276] Kur'an, 2: 256

[277] Kur'an, 1: 7

O shoku im, që po më shoqëron mua në udhëtimin tim imagjinar! Ajo tokë është natyra dhe filozofia Natyraliste. Tuneli është rruga që kanë hapur filozofët me mendimin e tyre me qëllim që ta arrijnë të vërtetën. Gjurmët e këmbëve të tyre që unë pashë ishin ato filozofë të famshëm si *Platoni* dhe *Aristoteli*. [278] Zërat që dëgjova, ishin zërat e gjenive si *Ibnu Sina* dhe *Farabiu*. Po, në të vërtetë, unë shikoja disa fjalë dhe parime në disa vende të ndryshëm që i pati thënë *Ibnu Sina*, por ai kishte ngecur krejtësisht, ai nuk mundi të shkonte më tutje, domethënë ai u mbyt para se të arrinte të vërtetën. Sidoqoftë, me qëllim që të të shpëtojë ty nga kureshtja, unë të tregova ty një pjesë të vogël të së vërtetës. Tani unë po i kthehem udhëtimit tim.

Dalëngadalë unë kuptova se mua më ishin dhënë në dorë dy gjëra për t'i përdorur. Njëra ishte një elektrik dore, ai do të largonte errësirat e dendura të Natyrës nëntokësore. Gjëja tjetër ishte një mjet i madh i cili, duke thyer shkrepa të fuqishëm dhe shkëmbinj të mëdhenj si male, do të hapte një rrugë për mua. Atëherë, një zë më tha tek veshi im: "Ky elektrik dore dhe ky mjet të janë dhënë ty nga thesari i Kur'anit."

Kështu, udhëtova për një kohë të gjatë në këtë rrugë. Atëherë, papritmas, dola në anën tjetër. Unë pashë një botë ku gjithçka ishte gazmore, drita e diellit shndriste në një qiell të pastër e të bukur pa re, frynte një fllad gjallërues dhe rrjedhte një ujë i shijshëm jetëdhënës. Ndërkohë thashë: *"**El hamdu lil-lah!**" I gjithë falënderimi i takon Zotit xh.sh.!* Atëherë kuptova se Unë nuk e kisha në pronësi veten time, dikush po më testonte e po më provonte mua.

Ndërsa në pjesën e parë të udhëtimit, e gjeta veten në atë shkretëtirë të madhe nën renë mbytëse, dhe megjithëse tani në një rrugë tjetër,

---

[278] Në qoftë se ti thua: "Po kush je ti që po i sfidon këta filozofë të famshëm? Ti je thjesht si një mizë dhe megjithatë ti ndërhyn në fluturimin e shqiponjave"?

Atëherë unë do t'i përgjigjesha: ***"Ndërsa duke pasur një mësues parapërjetësie si Kur'anin në çështjet lidhur me të vërtetën dhe njohjen e Zotit xh.sh. , unë nuk duhet t'u jap vlerë as sa krahu i një mize atyre shqiponjave, të cilët janë studentët e filozofisë së ndotur me ç'udhëzim dhe të intelektit të mashtruar. Sado më i ulët të isha në shkallë se sa ata, mësuesi i tyre është një mijë herë më i ulët se sa mësuesi im. Me ndihmën e Mësuesit tim, materia e cila i mbyti ata, nuk mundi as edhe të lagë këmbën time. Po, një ushtar i thjeshtë i cili vepron në përputhje me ligjet dhe komandat e një mbreti të madh është në gjendje të arrijë më shumë rezultate të mëdha se sa një mareshallë i një mbreti të vogël..."***

përsëri dikush po më shtynte mua, këtë herë nuk ishte nën tokë, përkundrazi, unë po e bëja këtë udhëtim të gjatë mbi faqen e tokës me qëllim që të arrija anën tjetër. Unë pashë në këtë udhëtim gjëra aq të çuditshme e plot kureshtje saqë ato nuk mund të përshkruhen: deti ishte në furtunë e i zemëruar me mua. Stuhitë më kërcënonin dhe gjithçka më shkaktonte problem. Por përsëri me mjetet e udhëtimit që më ishin dhënë nga Kur'ani, i mposhta ato dhe i kalova.

Gjatë rrugës unë pashë se gjithandej ndodheshin kufomat e udhëtarëve. Ata që kishin plotësuar udhëtimin e tyre ishin një në një mijë. Sidoqoftë.. duke pas shpëtuar nga errësirat e asaj reje mbytëse unë kisha arritur anën tjetër të tokës dhe kisha dalë në shikimin e plotë të diellit të shkëlqyer të realitetit. Duke marrë frymë në flladin gjallërues, unë thashë ***"El hamdu lil-lah."*** *I gjithë falënderimi i takon Zotit xh.sh..* Ndërkaq, fillova të sodis përreth asaj bote të bukur si Parajsa.

Pastaj unë pashë se ndodhej dikush që nuk do të më linte mua të qëndroja këtu. Menjëherë ai më mori nga ajo shkretëtirë e madhe sikur donte të më tregonte një rrugë tjetër. Atje pashë lloje të ndryshme gjërash, disa si aeroplanë, disa si makina, disa si çikrikë -vinça- të cilët sikur kishin zbritur nga lartë me ashensorë.

Kështu, cilido njeri mund të lidhej me njërën nga ato gjëra, sipas aftësisë dhe fuqisë së tij dhe me të, të ngjitej lart. Edhe unë gjithashtu hipa në njërën prej tyre dhe për një minutë ajo më ngjiti sipër reve dhe sipër majeve të bukura, të blerta e të mahnitshme të maleve; madje retë nuk arritën më shumë se gjysmën e rrugës lart maleve. Gjithandej frynin erërat dhe flladet më të buta, gjithkund gjendej uji më i shijshëm dhe dritat më të buta. Unë pashë se gjithandej ndodheshin këto mjete të ndritshme ngjitjeje që u ngjasonin ashensorëve. Megjithëse unë i kisha parë ato në të parën e dy pjesëve të udhëtimit tim dhe mbi anën tjetër të tokës, nuk i kisha kuptuar se çfarë ishin ato. Tani kuptova se ato ishin shfaqjet e vërseteve të Kur'anit të gjithurtë.

Kështu, **Rruga e Parë**, e cila tregohet nga وَلاَ الضَّالِّينَ *"Jo në rrugën e atyre të cilët humbën"*, është ajo e atyre që janë të mbytur në Natyrë dhe të cilët janë ndjekësit e filozofisë së Natyralizmit. Ju keni parë në këtë Rrugën e parë se sa shumë vështirësi ndodhen në kalimin për tek e vërteta dhe drita.

Rruga e Dytë, e cila tregohet nga, غَيْرِ الْمَغْضُوبِ *"Jo në rrugën e atyre që merituan zemërimin Tënd mbi vete"* është ajo e atyre që adhurojnë shkaqet dhe e atyre të cilët u japin fuqi për të krijuar dhe efekt ndërmjetësve ashtu si filozofët peripatetikë -aristotelianë. Këta u përpoqën të arrinin realitetin e të vërtetave dhe njohjen e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm, vetëm nëpërmjet arsyes dhe intelektit.

Sa për **Rrugën e Tretë**, e cila tregohet nga اَلَّذِينَ اَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ *"Në rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mirësinë Tënde"*, ajo është rruga e ndritshme e njerëzve të Kur'anit, të cilët janë njerëzit e rrugës së drejtë. Rruga e ndritshme është një rrugë brilante e shpallur dhe e dhuruar nga i Gjithëmëshirshmi i vetëm. Ajo është rruga më e shkurtër, më e lehtë dhe më e sigurta dhe, ajo është e hapur për gjithkënd.

* * *

QËLLIMI I DYTË

Lidhet me Transformimin e Grimcave të Vogla

Qëllimi i dytë tregon një xhevahir të vetëm nga thesari i vërsetit të mëposhtëm.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمنِ الرَّحِيمِ

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لاَ تَاْتِينَا السَّاعَةُ قُلْ بَلَى وَ رَبِّى لَتَاْتِيَنَّكُمْ عَالِمِ الْغَيْبِ لاَ يَعْزُبُ عَنْهُ مِثْقَالُ ذَرَّةٍ فِى السَّموَاتِ وَلاَ فِى الْاَرْضِ وَلاَ اَصْغَرُ مِنْ ذلِكَ وَلاَ اَكْبَرُ اِلاَّ فِى كِتَابٍ مُبِينٍ

Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Dhe ata që nuk besojnë, thonë: 'Ora nuk do të vijë tek ne'. Thuaju (o Muhammed): 'Po, për Zotin tim! Ajo do të vijë mbi ju (për All-llahun!) i Gjithëdituri i së fshehtës. As edhe një atom, ose më i vogël se ai, ose më i madh nuk shpëton nga Dijenia e Tij në qiej ose në tokë, veçse është në Librin e Qartë."[279]

[Ky qëllimi i Dytë tregon vetëm sa një peshë atomi, prej thesarit të madh të këtij vërseti; domethënë, ai tregon vetëm disa xhevahire nga arkat që janë grimcat. Ky diskuton në një shkallë të vogël lëvizjen dhe detyrat e grimcave. Ky qëllim përbëhet nga një "Parathënie" dhe "Tre Pika".]

[279] Kur'an, 34: 3

PARATHËNIE

Transformimet e grimcave janë: Dridhjet, lëkundjet, dhe bredhjet që ndodhin gjatë kohës që janë duke u shkruar shenjat e krijimit në librin e universit nga pena e fuqisë së Skalitësit të Parapërjetësisë.

Ato nuk janë lojëra të rastësisë apo një lëvizje kuturu, të parregullt, dhe të paqëllimtë ashtu siç e pandehin materialistët dhe natyralistët, sepse: Ashtu si të gjitha qëniet, çdo grimcë thotë në fillimin e lëvizjes së saj ***"Bismil-lah"*** *-me Emrin e All-llahut-*, sepse: ajo, e cila është sa një kokërr gruri, mban pesha që kalojnë pafundësisht fuqinë e saj, ashtu si fara e pishës që mban mbi shpatulla pemën e saj gjigante...

Pastaj kur plotëson detyrën e saj, ajo thotë: ***"El hamdu lil-lah"*** *Lavdia i takon All-llahut*, sepse duke shfaqur një art që është i bukur dhe plot qëllim dhe një dekorim që është i hijshëm dhe plot dobi sa habisin mendjet, ajo shfaq një vepër arti ashtu si një poemë, në lavdërimin e Krijuesit të Gjithëlavdishëm; për shembull: shikoji me vëmendje shegat dhe misrin.

Në të vërtetë, ***Transformimet e grimcave***[280] janë lëvizja dhe dridhjet kuptimplote që veprojnë në përputhje me urdhrin dhe parimet

---

[280] Ky shënim është një shpjegim i një fjalie të gjatë [këtu, një paragraf] duke përcaktuar transformimet e grimcave të vockëla, i cili është subjekti i Qëllimit të Dytë. ***"Imamun Mubin", "Regjistruesi i Qartë"*** dhe ***"Kitabun Mubin","Libri i Qartë",*** përsëriten në disa vende në Kur'anin e gjithurtë. Një grup i komentatorëve të Kur'anit mendojnë se ato janë të "Njëjtët", ndërsa të tjerët deklaruan se ato janë "të Ndryshëm nga njëri-tjetri" dhe i shpjeguan realitetet e atyre të dyve në mënyrë kontradiktore, dhe përmbledhja e asaj që thanë është se, të dyja ato janë "Tituj që përshkruajnë 'Njohjen Hyjnore.' Por, nëpërmjet shkëlqimit të Kur'anit, unë arrita në përfundimin se:

"Regjistruesi i Qartë", i cili shikon më shumë tek Bota e Padukshme se sa tek Bota e Dukshme, ishte një titull për njërin aspekt të njohjes së Zotit xh.sh. dhe të urdhrit të Tij. Domethënë, ai shikon më shumë tek e shkuara dhe e ardhmja se sa tek koha e tashme. Ai shikon më shumë tek origjina e çdo gjëje dhe prejardhjet e saj dhe tek rrënjët dhe farërat e çdo gjëje, se sa i shikon ato tek ekzistenca e tyre e jashtme dhe e dukshme. Ai është një Regjistër shënimi për Kaderin Hyjnor. Ekzistenca e këtij Regjistri është provuar në Fjalën e Njëzet e Gjashtë dhe gjithashtu në Shënimin e Fjalës së Dhjetë. Po, në të vërtetë, ***Regjistruesi i Qartë,*** është një lloj titulli për njohjen dhe urdhrat e Zotit xh.sh. Domethënë, origjinat, burimet dhe rrënjët prej të

cilave vijnë gjërat në ekzistencë me rregull të plotë dhe me art, tregojnë se ato duhet të administrohen e menaxhohen në përputhje me një Regjistër shënimi të parimeve të Njohjes Hyjnore.

Dhe për shkak se rezultatet, pasardhjet dhe farërat e gjërave përmbajnë indekset dhe programet e qënieve të cilat do të vijnë në ekzistencë më vonë, në vijim, tregojnë se ato duhet të jenë një Regjistër i vogël i urdhrave Hyjnorë. Për shembull: Një farë mund të shikohet si programi dhe indeksi që do t'i japë formë strukturës së të gjithë pemës; dhe për më tepër, si një trupëzim i vogël i urdhrave që e bëjnë pemën të vijë në ekzistencë dhe përcaktojnë programet dhe indekset e saj. Shkurtazi: ***"Regjistruesi i Qartë"*** është si një indeks dhe program i pemës së krijimit, e cila i ka shpërndarë degët e saja në çdo pjesë të së shkuarës, të ardhmes dhe të Botës së padukshme. Në këtë sens, ***"Regjistruesi i Qartë"*** është një Fletore shënimesh dhe Regjistër i parimeve të Kaderit Hyjnor. Nëpërmjet urdhrit dhe kërkesës së atyre parimeve, grimcat vihen në punë në detyrat e tyre dhe lëvizin në gjëra.

Sa për ***"Librin e Qartë"***, ai shikon më shumë tek Bota e Dukshme se sa tek Bota e Padukshme. Domethënë, ai shikon më shumë tek koha e tashme se sa tek e shkuara dhe e ardhmja. Ai është një titull, një regjistër shënimi, një libër i dëshirës dhe i fuqisë së Zotit xh.sh., më shumë se sa i njohjes dhe i urdhrave të Tij. Në qoftë se ***"Regjistruesi i Qartë"*** është një regjistër shënimi për Kaderin Hyjnor, ***"Libri i Qartë"*** është një regjistër për Fuqinë Hyjnore. Domethënë, fakti se çdo gjë në ekzistencën e saj, në esencën, atributet dhe në funksionet shfaq një art të plotë dhe një rregull, provon se asaj i është dhënë ekzistencë nëpërmjet ligjeve të një 'Vullneti efektiv dhe të parimeve të një Fuqie të padefekt. Dhe ashtu si formën e saj të specifikuar dhe individuale, çdo gjëje i është dhënë një masë e përcaktuar dhe një trajtë e veçantë. Prandaj, fuqia dhe dëshira kanë një Regjistër universal e gjithëpërfshirës, një regjistër të madh, sipas të cilit forma e veçantë dhe substanca e çdo gjëje pritet, qepet dhe vishet.

Ekzistenca e këtij Regjistri, si ***"Regjistruesi i Qartë"***, është provuar midis çështjeve të kaderit Hyjnor dhe dëshirës së pjesshme të Njeriut. Vetëm shihe budallallëkun e njerëzve të neglizhencës, të ç'udhëzimit dhe të filozofisë, ata kanë perceptuar se ***"El-Leul Mahfudh" "Pllaka e Ruajtur"*** e Fuqisë Krijuese dhe shfaqja, refkletimi dhe demonstrimi në gjërat e atij libri të shkruara qartë të urtësisë Hyjnore dhe të dëshirës, dhe përsëri, ruajna Zot, duke e quajtur atë ***"Natyrë"***, ata e kanë bërë atë krejtësisht të verbër e të pakuptimtë, ndërsa nëpërmjet urdhrit të ***Regjistruesit të Qartë***, domethënë, nëpërmjet dekretit dhe instruksionit të Kaderit Hyjnor, Fuqia Hyjnore krijon zinxhirin e qënieve, ku çdo hallkë a lidhje e të cilit është një shenjë në krijimin e gjërave.

Ai shkakton lëvizjen e grimcave, ai shkruan dhe krijon në fletën metaforike të kohës, e cila quhet ***"Tabela e zhdukjes dhe e Ripohimit". Kështu, lëvizja e grimcave është dridhje dhe lëvizje nga ai shkrim dhe tejshkrim, e cila ndodh kur qëniet kalojnë nga bota e Padukshme për në botën e Dukshme, ashtu siç kalojnë ato nga njohuria për tek Fuqia.***

e ***'Librit të Qartë'***, i cili është titulli i Njohjes Hyjnore dhe i Urdhrit, është vendosja dhe dispozita ligjore e origjinës së shkuar dhe i pasardhësve të së ardhmes së çdo gjëje në Botën e të Padukshmes.

Ato veprojnë nëpërmjet tejshkrimit -transkriptimit, kopjimit- nga ***'Libri i Qartë'***, i cili është një titull për Fuqinë Hyjnore dhe Dëshirën. Ai formohet nga e tashmja dhe nga bota e dukshme, si dhe përbëhet nga ushtrimi i lirë i pushtetit të asaj fuqie dhe dëshire në krijimin e gjërave.

Kështu, kjo lëvizje dhe këto dridhje kuptimplote burojnë nga shkrimi dhe nga skicimi i fjalëve të Fuqisë në ***"Pllakën e shkrimit të zhdukjes dhe të ripohimit"***, e cila është një fletë metaforike, dhe realiteti i rrjedhës së kohës.

PIKA E PARË: Pika e parë diskuton dy çështje:

Çështja e parë: Në çdo lëvizje dhe në çdo qetësi të çdo grimce, shndrisin Dy dritat e Unitetit Hyjnor si dy Diej, sepse siç është provuar shkurtazi në Treguesin e Parë të *Fjalës së Dhjetë* dhe me hollësi tek *Fjala e Njëzet e Dytë,* në qoftë se çdo grimcë nuk do të ishte një nëpunëse e ngarkuar nga Zoti xh.sh. duke vepruar me lejen e Tij dhe nën autoritetin e Tij, dhe në qoftë se ajo nuk do të transformohej me Njohurinë dhe me Fuqinë e Tij, atëherë çdo grimcë duhej të kishte njohje të pafundme dhe Fuqi të pakufishme; ajo duhej të kishte sy që të shikonte gjithçka, një fytyrë që të orientohej drejt të gjitha gjërave dhe të kishte autoritet mbi të gjitha gjërat, sepse çdo grimcë prej elementeve vepron ose mund të veprojë në një mënyrë të rregullt tek të gjitha qëniet e gjalla. Por, rregulli brenda gjërave dhe ligjeve në përputhje me të cilat ato formohen, ndryshojnë nga njëra gjë tek tjetra.

Sa për ***"Tabelën e zhdukjes dhe të ripohimit",*** ajo është një pllakë për të shkruar e për të fshirë një regjistër gjithmonë të ndryshueshëm të ***"El-Leul El Mahfudhu El A'dham",'Tabelës më të madhe të Ruajtur'***, e cila është e palëvizshme dhe e qëndrueshme. Ai është regjistri i ***'shkrimit dhe i fshirjes'*** në sferën e mundësisë, ku të gjitha gjërat janë manifestime të pareshtura, të pandërprera të jetës dhe vdekjes, të ekzistencës dhe të përkohshmërisë. Dhe ky është ***realiteti i kohës***. Në të vërtetë, ajo që ne e quajmë kohë, e cila është një lum i fuqishëm duke rrjedhur në krijim, ka një realitet si çdo gjë tjetër. Realiteti i saj është si boja dhe fleta e shkrimit të Fuqisë në ***'Tabelën e zhdukjes dhe të ripohimit"***. لاَ يَعْلَمُ الْغَيْبَ اِلاَّ اللّٰهُ *Askush nuk e di të panjohurën përveç All-llahut xh.sh.!*

Në qoftë se rregulli nuk do të ishte i njohur për grimcat, ato nuk do të mund të vepronin, madje edhe në qoftë se do të mund të vepronin, ato nuk do të mund të vepronin pa gabim. Mirëpo ato funksionojnë pa gabim. Atëherë, grimcat të cilat po kryejnë detyrat e tyre në qëniet, ose veprojnë me lejen dhe në përputhje me urdhrat e të Vetmit i Cili zotëron njohuri gjithëpërfshirëse për gjithçka dhe brenda dijes dhe dëshirës së Tij, ose do të duhej që ato grimca të kishin Njohuri Gjithëpërfshirëse dhe Fuqi Absolute.

Po, në të vërtetë, të gjitha grimcat e ajrit mund të futen në të gjitha trupat e qënieve të gjalla, në frutat e të gjitha luleve dhe në strukturat e të gjitha gjetheve. Ato mund të veprojnë brenda tyre, ndonëse mënyra në të cilën ato formohen janë të gjitha të ndryshme dhe rregulli e sistemet e tyre janë krejtësisht të dallueshëm. Në qoftë se, për shembull, fabrika e një fruti fiku do të ishte e ngjashme me një vegjë -tezgjah- për thurje, fabrika e frutit të shegës do të ishte e ngjashme me fabrikën e prodhimit të sheqerit dhe kështu me radhë... dhe programet e strukturave të tyre dhe trupat, që të gjithë ndryshojnë nga njëri-tjetri. Atëherë, një grimcë e ajrit futet ose mund të hyjë tek të gjitha ato. Ajo merr pozitën e saj dhe vepron në një mënyrë të urtë, mjeshtërisht e pa gabime. Dhe sapo të përfundojë detyrën e saj, ajo largohet.

Kështu, grimca e lëvizshme në ajrin e lëvizshëm ose duhet t'i njihte format, trajtat, masat dhe trajtëzimet me të cilat vishen bimët e kafshët, dhe madje edhe frutat dhe lulet, ose ajo grimcë duhet të jetë një nëpunëse duke vepruar me urdhrin dhe vullnetin e Një të vetmi që njeh gjithçka. Po ashtu, çdo grimcë e palëvizshme në dheun e qetë të palëvizshëm, meqenëse ka aftësi për të qenë mjeti dhe vendi i mbjelljes për të gjitha farërat e të gjitha bimëve të lulëzuara dhe e pemëve frutdhënëse, sepse në qoftë se ajo farë do të hidhej në një grusht dhé, që përbëhet nga grimca të ngjashme, si të ishin një grimcë e vetme, dhe do të takonte cilëndo farë që gjendet në të; atëherë ajo do të gjente një fabrikë të veçantë për të dhe të gjitha pajisjet dhe makineritë e domosdoshme për drejtimin e asaj fabrike; domethënë do të gjendeshin në atë grusht dhé, e cila është shtëpiza e grimcës, fabrika dhe makineri jolëndore të holla të panumërta aq sa numri i llojeve të bimëve, të pemëve, të luleve dhe të fruteve! Ose ndryshe do të duhej të ishte një njohje e gjerë e mrekullueshme dhe një fuqi gjithëpërfshirëse për gjithçka nga asgjëja, ose ato detyra kryhen me urdhrin dhe me lejen e Një të Vetmi i Cili është i Gjithëditur mbi gjithçka, dhe përmes

forcës dhe fuqisë së Një të Vetmi i Cili është i Gjithëfuqishëm Absolut mbi të gjitha gjërat.

Po, në të vërtetë, në qoftë se një njeri i pa ushtruar, i papërvojë, i thjeshtë, i zakonshëm dhe i verbër do të shkonte në Evropë dhe, në qoftë se do të hynte atje tek të gjitha fabrikat dhe tezgjahët, dhe do të shfaqte një mjeshtëri e urtësi artistike në një shkallë të tillë, saqë gjithkush do të mbetej shtang pa gojë nga habia, padyshim, ai që do të kishte sa një grimcë vetëdije, do ta dinte me siguri se personi në fjalë nuk po vepronte me iniciativën e vet, porse një profesor mjeshtër e ka instruktuar atë dhe e ka bërë atë të punojë.

Dhe në qoftë se, gjithashtu, do të ndodhej një njeri i verbër dhe i pafuqishëm i cili ka jetuar në një shtëpi të thjeshtë të vogël dhe është i paaftë madje të ngrihet edhe nga vendi i tij, dhe në qoftë se copëza të vogla guri dhe copa e thërrime prej materialeve, si kockat ose pambuku, do të hynin në shtëpizën e tij, dhe pastaj do të dilnin prej asaj shtëpize thasë sheqeri, dengje pëlhurash, me mijëra xhevahire, rroba të punuara për bukuri të veshura me gurë të çmuar, dhe ushqime të shijshme, atëherë a nuk do të thonte ai që do të kishte mend sa një grimcë se: "Ai njeri i verbër fatkeq që nuk mund të ngrihej as nga vendi i tij, është vetëm një derëtar i dobët ose thjesht një shërbëtor ose një shul tek dera e fabrikës së një Pronari Mrekullibërës, e cila është burim i mrekullive të Tij."

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, lëvizja dhe detyrat e grimcave të ajrit në bimët, pemët dhe në lulet e frutat, secila prej tyre është një mesazh i Krijuesit të vetëm të përjetshëm, është një vepër antike Hyjnore arti, një mrekulli e Fuqisë Hyjnore, një çudi e urtësisë Hyjnore; ato tregojnë se grimcat po veprojnë nën urdhrin dhe dëshirën e një Autori të Gjithurtë e të Gjithëlavdishëm dhe të Një Krijuesi Gjithëbujar e Hirplotë.

Të gjitha grimcat e dheut gjithashtu, meqenëse janë burimi dhe mjetet për filizat dhe bimët e prodhuara nga farërat, secila prej tyre është një fabrikë e ndryshme dhe bankë pune, një presë tipografike e ndryshme, një thesar, një antikë, një afishe, një manifest i ndryshëm duke shpallur Emrat e Krijuesit të Gjithëlavdishëm, ajo është një poemë duke u thurur lavde plotësimeve të Tij, dhe është aq e sigurt sa dy dhe dy bëjnë katër, se ato po veprojnë me urdhrin, me lejen dhe nëpërmjet vullnetit dhe fuqisë së Një Krijuesi të Gjithëlavdishëm i Cili

është Pronari i urdhrit كُنْ فَيَكُونُ *"Bëhu!- dhe ajo është bërë (në çast)!"*[281] urdhrit të të Cilit i nënshtrohet çdo gjë. ***Në këtë ne besojmë...***

Çështja e dytë: Çështja e dytë është një tregues i shkurtër për detyrat dhe shembujt e urtësisë në lëvizjen e grimcave.

Materialistët, përdorimi i arsyeve të të cilëve është kufizuar drejtpërdrejtë me atë çfarë është e dukshme për sytë e tyre, në filozofitë e tyre absurde të cilat mbështeten mbi themelet e kotësisë, i kanë marrë transformimet e grimcave, të cilat ata i vlerësojnë si rezultatet e rastësisë, si bazat themeltare të të gjitha parimeve të tyre dhe kanë treguar se artifaktet Hyjnore dhe krijesat shkaktohen nga ato transformime. Ai i cili do të kishte një grimcë vetëdije do ta dinte me siguri se sa në kundërshtim me arsyen është të atribuarit e këtyre krijesave të stolisura me shembuj të pafundmë urtësie diçkaje që bazohet mbi rastësinë e paqëllimtë e të pakuptimtë, e cila është krejtësisht pa rregull.

Ndërsa nga këndvështrimi i urtësisë së Kur'anit të gjithurtë, transformimet e grimcave kanë shumë qëllime e detyra dhe demonstrojnë shumë shembuj urtësie. Kur'ani i tregon këto detyra dhe shembuj urtësie nëpërmjet shumë vërseteve të tij, si:

وَ اِنْ مِنْ شَيْءٍ اِلاَّ يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

"Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij."[282]

Ne do të përmendim disa nga këto nëpërmjet shembujve.

I pari: Duke ripërtërirë e rifreskuar shfaqjet e aktit të Tij të krijimit, Ekzistuesi i Domosdoshëm dhe Krijuesi i Gjithëlavdishëm i bën grimcat të lëvizin dhe i vë ato në shërbim nëpërmjet fuqisë së Tij, duke e marrë çdo shpirt si një model me qëllim që në çdo vit t'i veshë atij një trup të freskët nëpërmjet mrekullive të fuqisë së Tij, të transkriptojë, tejshkruajë, me urtësinë e Tij prej çdo libri individi mijëra e mijëra libra të ndryshëm dhe, për të demonstruar një të vërtetë të vetme në forma gjithmonë të ndryshme, dhe gjithashtu me qëllim që

[281] Kur'an, 36:82

[282] Kur'an, 17: 44

të përgatisë terrenin për ardhjen e qënieve të reja, botëve të reja dhe ekzistencave të reja, grup pas grupi.

I dyti: Pronari i Gjithëlavdishëm i të gjithë sundimit e krijoi këtë dynja dhe veçanërisht fushën e faqes së tokës, në formën e pasurisë së kultivuar. Domethënë, Ai e përgatiti atë në një mënyrë që ajo do të lulëzonte e prodhonte të korra gjithmonë të freskëta me qëllim që Ai të mund të mbjellë e të korrë mrekulli të panumërta të fuqisë së Tij.

Kështu, duke shkaktuar lëvizjen e grimcave me urtësi dhe duke i vënë ato në shërbim në një mënyrë të rregullt në fushën e Tij të faqes së tokës, Ai shfaq në çdo shekull, në çdo stinë, në çdo muaj dhe madje në çdo ditë e në çdo orë qënie të pafundme të ripërtërira nëpërmjet mrekullive të fuqisë së Tij, secila prej tyre është si një botë, dhe e bën fushën e Tij të prodhojë të korra gjithmonë të ndryshme. Ai demonstron nëpërmjet lëvizjes së grimcave këto dhurata prej thesarit të pashtershëm të Mëshirës së Tij dhe shembujt e fuqisë së Tij të pafundme.

I treti: Skalitësi i Parapërjetësisë e bëri lëvizjen e grimcave me urtësi të plotë dhe i vu ato në shërbim me rregull të plotë me qëllim që, nëpërmjet shfaqjes së qëndisjeve të manifestimeve të pafundme të Emrave Hyjnorë, Ai të mund të ekspozojë qëndisjet e pafundme në një fushë të kufizuar, me qëllim që të shprehë manifestimet e Emrave dhe me qëllim që Ai të mund të shkruajë shenjat e pafundme, të cilat do të tregojnë kuptimet e pafundme në një fletë të vogël.

Në të vërtetë, në esencë prodhimet e këtij viti janë si ato të vitit të kaluar, por kuptimet e tyre janë të ndryshme. Meqenëse përcaktimet relative ndryshohen, kuptimet e tyre ndryshojnë dhe shtohen. Dhe megjithëse përcaktimet relative dhe personifikimet e përkohshme zëvendësohen, dhe në dukje janë të përkohshme, kuptimet e tyre të bukura ruhen dhe janë të përhershme e të qëndrueshme.

Meqenëse gjethet, lulet dhe frutat e pemës së pranverës së kaluar nuk kanë shpirtra (nuk mbajnë shpirtra si ai i njeriut), ato janë në realitet të njëjtat si ato të kësaj pranvere. Por ndryshime ka vetëm në personifikimet relative; dhe personifikimet relative të kësaj pranvere zëvendësojnë ato të pranverës së kaluar me personifikime të ndryshme me qëllim që të tregojnë kuptimet dhe funksionet e Emrave Hyjnorë, manifestimet e të cilëve ripërtërihen vazhdimisht.

I katërti: I Gjithurti i Vetëm Madhështor e bën lëvizjen e grimcave në kultivimin e kësaj dynjaje të ngushtë, në punishten dhe në fushën e faqes së tokës, duke e bërë kështu kozmosin sikur të rrjedhte dhe qëniet sikur të udhëtonin, me qëllim që të rriten gjërat, ose gjërat për dekorim, ose furnizimi i përshtatshëm për botën më të gjërë të dimensioneve të brendshme të gjërave, dhe për botët e tjera të pafundme të Ahiretit, si Bota e pafundme e shëmbëllesës. Ai kështu, zhvillon e përgatit në këtë botë të vogël sasira të mëdha të korrash jolëndore të përshtatshme për ato botëra të gjëra.

Ai bën të rrjedhë një vërshim të pafund nëpërmjet dynjasë që buron prej thesarit të pashtershëm të fuqisë së Tij dhe të derdhet në botën e të padukshmes dhe një pjesë të tij në botët e Ahiretit.

I pesti: Duke e shkaktuar lëvizjen e grimcave me urtësi të plotë nëpërmjet Fuqisë së Tij dhe duke i vënë ato në shërbim me rregull të plotë me qëllim që të shfaqë plotësimet e pafundme Hyjnore, manifestimet e pafundme të bukurisë dhe të lavdisë, lavdërimet e pafundme Hyjnore, në këtë fushë të ngushtë e të kufizuar dhe në këtë kohë të kufizuar e të shkurtër, Ai shkakton lavdërime të pafundme në një kohë të kufizuar dhe në një fushë të kufizuar. Ai shfaq manifestime të pafundme të Bukurisë së Tij, të lavdisë dhe të plotësimit. Ai krijon shumë të vërteta që lidhen me të padukshmen, shumë fruta për Ahiretin, shumë qëndisje dhe thurje kuptimplota të paracaktuara të formave të krijesave të përkohshme dhe të identiteteve të tyre të qëndrueshëm të përshtatshme për botën e shëmbëllesës dhe të pllakës - tablosë. Domethënë, Ai që shkakton lëvizjen e grimcave është Ai i Cili i shfaq këto qëllime të mëdha dhe këto shembuj të fuqishëm urtësie. Në qoftë se do të ishte ndryshe, atëherë do të duhej që çdo grimcë të kishte një mendje aq të madhe sa dielli!

Ata filozofë të pa tru i supozojnë të paqëllimta e pa urtësi transformimet e grimcave, të cilat ndodhin me urtësi të madhe jo vetëm si tek këto pesë shembujt e lartpërmendur, por ndoshta brenda pesë mijë shembujsh urtësie. Ata i pandehin grimcat, të cilat rrotullohen si dervishë mevlevi duke lavdëruar Zotin xh.sh. dhe duke recituar Emrat e Tij në dy lëvizje të dalldisura në ekstazë, njëra duke i rrotulluar në boshtet e tyre dhe tjetra duke përshkruar rrethet, të sillen përqark sikur të trullosura e pa qëllim.

Atëherë, nga kjo mund të kuptohet se njohja e tyre nuk është njohje, ajo është injorancë dhe filozofia e tyre është kotësi.

(Një shembull i gjashtë dhe i gjatë do të diskutohet në Pikën e Tretë.)

PIKA E DYTË: ***Në çdo grimcë ndodhen dy dëshmi të vërteta për ekzistencën dhe për Unitetin e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm.***

Po, në të vërtetë, duke kryer detyrat e saj të rëndësishme me vetëdije dhe duke mbajtur pesha të mëdha, pavarësisht qënies së saj të pafuqishme dhe të pajetë, një grimcë jep dëshmi vendimtare për Ekzistencën e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm. Dhe duke iu përshtatur rregullit të përgjithshëm të veçantë për çdo vend që ajo futet, dhe duke zënë vend kudo sikur të ishte atdheu i saj, ajo dëshmon Unitetin e All-llahut dhe Njësinë e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm i Cili është Pronari i të gjitha gjërave të dukshme dhe i atyre të dimensioneve të brendshme të tyre, pra, të gjërave të padukshme. Domethënë, ai që i ka në pronësi grimcat, duhet gjithashtu të jetë edhe pronar i të gjitha vendeve ku ato shëtisin. kështu, meqenëse peshat e grimcës janë tej mase të rënda dhe detyrat e saja janë të pafundme, grimca demonstron se është e lëvizshme dhe vepron me urdhrin e të Gjithëfuqishmit absolut, me emrin e Tij dhe me fuqinë e Tij. Dhe fakti se ajo përshtatet sikur ta njihte rregullin e përgjithshëm të kozmosit dhe futet në secilin vend pa pengesë, tregon se ajo vepron nëpërmjet fuqisë dhe urtësisë së një të Gjithëdituri të Vetëm Absolut.

Po, në të vërtetë, një ushtar i thjeshtë ka një lidhje me skuadrën e tij, kompaninë, batalionin, regjimentin dhe divizionin e tij, e kështu me radhë.. dhe ka detyra në përputhje me secilën nga ato lidhje. Dhe meqenëse i njeh secilën nga ato lidhje e detyra, ai vepron në harmoni me to; kjo arrihet vetëm duke iu nënshtruar stërvitjes dhe instruksionit nën disiplinën ushtarake dhe duke iu përmbajtur dhe duke iu bindur rregullave të një komandanti të Vetëm suprem, i cili i komandon të gjitha ato grupe e sfera. Dhe në të njëjtën mënyrë, meqenëse çdo grimcë vendoset në mënyrë të përshtatshme me secilën nga sferat e shumta bashkëqendrore dhe me secilën ka një lidhje të ndryshme të dobishme dhe një detyrë të disiplinuar e të mirërenditur që japin rezultate të urta, të veçanta, sigurisht kjo është e veçantë vetëm për Pronarin e Vetëm, në dorën e të Cilit janë frerët e të gjitha gjërave në tërësinë e universit, i Cili e vendos atë grimcë në një vend të tillë saqë

ajo do t'i ruajë të gjitha lidhjet dhe detyrat në ato sfera dhe nuk do t'i prishë rezultatet e urta.

Për shembull, një grimcë e vendosur në beben e syrit të Tevfikut,[283] është vënë në mënyrë të përshtatshme dhe ka lidhje me enët e gjakut si arteriet e venat, dhe me nervat motorike -lëvizore- e ndijore të syrit dhe me urtësi të plotë ajo ka lidhje me fytyrën, dhe pastaj me kokën, me trungun e trupit dhe me tërësinë e trupit të njeriut. Ajo ka detyra të dobishme në lidhje me secilën. ***Kjo demonstron se vetëm Ai i Cili krijon gjymtyrët e të gjithë trupit do të jetë i aftë ta vendosë grimcën në atë pozicion***.

Në mënyrë të veçantë, grimcat duke hyrë në trup si vlera ushqyese në karvanin e ushqimit, e bëjnë udhëtimin e tyre me një rregull të çuditshëm dhe me një urtësi të tillë që habit mendjet. Në rrugën e tyre, ato kalojnë përmes metodave dhe fazave në një mënyrë të rregullt, dhe duke përparuar me aq vetëdije e pa ngatërresë sa që ato vazhdojnë derisa të kullohen nëpërmjet katër kullesave -filtrave- në trupat e qënieve të gjalla. Atëherë, ato ngarkohen në qelizat e kuqe të gjakut me qëllim që të vijnë për të ndihmuar gjymtyrët dhe qelizat të cilat kanë nevojë për ushqim, duke e dhënë këtë ndihmë në përputhje me ligjin e bujarisë. Nga kjo mund të kuptohet qartë se i Vetmi që i shtyn këto grimca dhe që i bën ato të kalojnë përmes mijëra gjendjeve të ndryshme duhet medoemos të jetë një Furnizues Gjithëbujar dhe një Krijues Mëshirë-plotë, në lidhje me fuqinë e të Cilit grimcat dhe yjet janë të barabarta.

Për më tepër, të gjitha grimcat veprojnë brenda qëndisjeve të artit më të madh dhe kanë lidhje me të gjitha grimcat e tjera atje. Meqenëse secila grimcë është në një pozitë edhe sunduese, dhe njëkohësisht e varur dhe e nënshtruar me të gjitha të tjerat, me çdo grimcë në mënyrë individuale, dhe me të gjitha ato në mënyrë të përgjithshme, ajo ose e njeh dhe e krijon atë qëndisje në formë të mrekullueshme dhe atë urtësi duke treguar art të stolisur, gjë e cila është njëmijë herë e pamundur, ose secila prej tyre është një pikë e urdhëruar për lëvizje, e cila buron nga ligji i Kaderit Hyjnor dhe nga pena e fuqisë së Krijuesit të Gjithurtë.

---

[283] (shënim: shkruesi i parë i Risale-i Nurit)

Për shembull, në qoftë se gurët e kupolës së xhamisë së Aja Sofias nuk do të ishin të varura tek urdhri dhe mjeshtëria e arkitektit të saj, atëherë çdo gurë duhej të ishte mjeshtër në artin e ndërtimit si e arkitekt Sinanit, dhe duhej të ishte ose sunduese për gurët e tjerë ose e nënshtruar prej tyre. Domethënë, ai duhet të kishte fuqinë për të thënë: "Ejani, o gurë, të qëndrojmë sup më sup të bashkuar, me qëllim që të mos biem e të mos shembemi."

Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se grimcat në krijesa, të cilat janë formuar me mijëra herë më me shumë mjeshtëri në mënyrë shumë më të mrekullueshme dhe më me shumë urtësi se sa kubeja e Aja Sofias, në qoftë se këto grimca nuk do të ishin të bindura e të nënshtruara ndaj urdhrit të Krijuesit madhështor, Krijuesit të universit, atëherë secilës prej tyre do të duhej t'i përshkruheshin aq shumë atribute plotësimi, aq sa ato të Krijuesit të Universit.

Subhanall-llah! Sa e çuditshme! Meqenëse jobesimtarët materialistë kryeneçë nuk e pranojnë All-llahun, Ekzistuesin e Vetëm të Domosdoshëm, ata detyrohen sipas besimeve të tyre të pranojnë aq shumë zota të rremë, aq sa numri i grimcave. Kështu, nuk ka rëndësi se sa filozof i shquar apo dijetar mund të jetë, mohuesi është në një padije të thellë, në shkallën më të skajshme të injorancës.

PIKA E TRETË: Kjo pikë është një tregues i shembullit të gjashtë prej shembujve të mëdhenj të urtësisë në lëvizjen e grimcave, e cila u premtua tek përfundimi i **Pikës së Parë**.

Ashtu siç u përmend në shënimin e përgjigjes së Pyetjes së Dytë në *Fjalën e Njëzet e Tetë*, një shembull tjetër urtësie prej mijërave, i përfshirë në transformimet e grimcave dhe lëvizja e tyre në trupat e qënieve të gjalla është të ndriçojë grimcat dhe t'i bëjë ato të gjalla dhe kuptimplota me qëllim që të jenë të përshtatshme për ndërtimin e botës së Ahiretit. Është sikur trupat e kafshëve e të njerëzve, dhe madje edhe bimët të ishin si bujtina, kazerma dhe shkolla për ata që futen. Me qëllim që të marrin mësime dhe të stërviten, grimcat e pajeta futen tek ato dhe ndriçohen. Thjesht, grimcat marrin stërvitje dhe instruksion dhe fitojnë një përsosuri e bukuri. Duke përmbushur detyra të ndryshme, ato bëhen të denja për të qenë grimca në botën e qëndrueshmërisë dhe në botën e Ahiretit, e cila është e gjallë me të gjitha elementet e saja.

Pyetje: Me çfarë njihet ekzistenca e kësaj urtësie në lëvizjet e grimcave?

Përgjigjja: ***Së pari:*** Ajo njihet nëpërmjet urtësisë së Krijuesit të Gjithurtë, e cila provohet nga të gjithë shembujt e urtësisë dhe nga rregulli në të gjitha krijesat, sepse urtësia Hyjnore, e cila i bashkëngjit urtësi të shumta universale edhe gjësë më të vogël e më të pjesshme, nuk do ta linte pa urtësi e qëllim lëvizjen e grimcave, të cilat demonstrojnë aktivitetin më të madh në rrjedhën e universit dhe janë shkaqe për shfaqjen e skalitjeve plot urtësi.

Pastaj, urtësia Hyjnore dhe sovraniteti i Saj, e cila nuk e lë edhe krijesën më të vockël pa një rrogë, shpërblim e plotësim në detyrat e saj, nuk do t'i linte nëpunësit e saj më të shumtë në numër dhe shërbëtorët kryesorë -grimcat- pa dritë ose pa shpërblim.

Së dyti: Duke bërë lëvizjen e elementeve dhe duke i vënë ato në punë, Krijuesi i Gjithurtë i ngre ato në shkallën e mineraleve sikur të ishte një shpërblim plotësimi, dhe i instrukton ato në tesbihatin, lavdërimin e veçantë për mineralet.. Dhe duke shkaktuar lëvizjen e mineraleve dhe duke i vënë në shërbim ato, Ai u jep atyre rangun e shkallës së jetës vegjetale -bimore.. dhe duke u dhënë jetën vegjetale në formën e ushqimit, Ai e dhuron atë nëpërmjet lëvizjeve të grimcave të bimëve dhe vënies në punë të tyre dhe i ngre ato në shkallën e hollë të kafshëve.. dhe i vë në shërbim grimcat e kafshëve; dhe nëpërmjet ushqimit i ngre ato në shkallën e jetës njerëzore.. Dhe duke i pastruar grimcat e trupit të njeriut nëpërmjet filtrimit të përsëritur, dhe duke i favorizuar ato, Ai i ngjit ato tek vendet më të holla e më të larta në trup, të cilat janë truri dhe zemra. Nga e gjitha kjo që u përmend, kuptohet se: ***Lëvizja e grimcave nuk është pa urtësi, por, përkundrazi, grimcat bëhen e shtyhen të nxitojnë për tek një lloj plotësimi i përshtatshëm për veten e tyre.***

Së treti: Midis grimcave në qëniet e gjalla, disa si grimcat e farërave dhe bërthamave marrin një dritë shpirtërore dhe një hollësi e hijeshi të stolisur dhe një cilësi të tillë, saqë ato sikur të ishin një shpirt, ose një mbret për grimcat e tjera dhe për vetë pemën madhështore.

Kështu, meqenëse midis të gjitha grimcave të një peme të madhe, disa ngrihen tek ky rang nëpërmjet përmbushjes së detyrave të tyre delikate dhe duke kaluar nëpërmjet shumë fazave në jetën e pemës, kjo demonstron se: ***Nëpërmjet urdhrit të Krijuesit të Gjithurtë, këto***

grimca marrin nga një hollësi jolëndore, nga një dritë jolëndore, rang dhe instruksion jolëndor për llogari dhe në favor të Emrave Hyjnorë të shfaqur mbi to në përputhje me llojet e lëvizjes që janë funksionet e natyrave të tyre dhe në nder të tyre.

Përmbledhje: Meqenëse Krijuesi i Gjithurtë ka specifikuar për çdo gjë një pikë të përshtatshme plotësimi dhe një nivel të përshtatshëm të shkëlqimit të ekzistencës, duke i dhënë çdo gjëje një mundësi që do të përpiqet ta arrijë atë pikë plotësimi, Ai i shtyn ato drejt saj. Ky ligj i Hyjnisë është në fuqi tek të gjitha bimët dhe kafshët, ashtu siç është në qëniet e pajeta, saqë Krijuesi i jep edhe dheut të zakonshëm një ngjitje që, me të, të arrijë shkallën e diamantit dhe shkallën e xhevahireve të çmuar. Dhe brenda kësaj të vërtete, shfaqet një maje prej një ligji madhështor, i cili është ***"Ligji i Hyjnisë."***

Dhe meqenëse Ai Krijues Gjithëbujar, duke i nënshtruar kafshët për të zbatuar ligjin e fuqishëm të riprodhimit, të ngjizjes, u jep atyre një kënaqësi të pjesshme si një shpërblim për kryerjen e asaj detyre nga ana e tyre, dhe u jep kafshëve që vihen në shërbim për të ekzekutuar urdhrat Hyjnorë, si bilbili dhe bleta, një shpërblim të lartë plotësimi dhe një pozitë që ngjall entuziazëm dhe kënaqësi. Dhe brenda kësaj të vërtete shfaqet një maje prej një ligji madhështor, i cili është ***"Ligji i Bujarisë".***

Dhe meqenëse ***realiteti i çdo gjëje shikon tek shfaqja e një Emri prej Emrave të bukur të Krijuesit dhe është i lidhur me Të, dhe ajo është si pasqyra reflektuese e dritave të Tij, atëherë ajo gjë, çfarëdo lloje bukurie të marrë, bukuria është për shkak të Atij Emri dhe për nderin e lartësinë e Tij; Ai Emër e kërkon atë të jetë kështu.*** Sido që të jetë gjëja, e vetëdijshme apo e pavetëdijshme, në këndvështrimin e realitetit ajo bukuri kërkohet. Dhe nga kjo e vërtetë shfaqet një maje prej një ligji madhështor, i cili është: ***"Ligji i Bukurisë dhe i Bërjes të Bukur."***

Dhe meqenëse, ashtu siç bëhet e domosdoshme nga ligji i Tij i Bujarisë, kur jeta dhe afati i një gjëje përfundon, Krijuesi Gjithëbujar nuk e merr prapa rangun dhe plotësimin që Ai ia ka dhënë asaj, përkundrazi, Ai i bën të qëndrueshëm frutat, rezultatet, kuptimin real dhe identitetin jolëndor të asaj mbajtëseje plotësimi dhe shpirtin e saj, në qoftë se ajo ka shpirt.

Për shembull, Ai i bën të qëndrueshëm kuptimet dhe frutat e plotësimeve të cilat Ai i ka bërë të dukshme tek njeriu në këtë botë saqë falënderimin e besimtarit mirënjohës dhe lavdërimin e tij për frutat kalimtare që ai ka ngrënë, All-llahu do t'ia kthejë atij përsëri në formën e një fruti të trupëzuar, të mishëruar e të mirë prej frutave të Xhennetit. Nga kjo e vërtetë zbulohet një majë prej një ligji madhështor i cili është ***"Ligji i Mëshirës."***

Dhe meqenëse Krijuesi i Pashoq, nuk çon dëm asgjë, dhe nuk bën asgjë më kot. Ai madje vë në përdorim e shfrytëzon edhe gërmadhat materiale të krijesave që kanë vdekur -të cilat i kanë përmbushur detyrat e tyre- në vjeshtën e kaluar, duke i përfshirë ato në ndërtimin e krijesave të reja në pranverë.

Sigurisht sipas misterit të, يَوْمَ تُبَدَّلُ الْاَرْضُ غَيْرَ الْاَرْضِ *"Ditën kur toka do të zëvendësohet me tjetër tokë."*[284]

Dhe treguesi i, وَاِنَّ الدَّارَ الْآخِرَةَ لَهِيَ الْحَيَوَانُ *"Vërtetë që banesa e jetës së pastajme – ajo është jeta e vërtetë"*[285], ***është në të vërtetë një kërkesë e urtësisë Hyjnore që grimcat e tokës, të cilat janë të pajeta dhe të pavetëdijshme dhe të cilat kanë kryer detyra të rëndësishme në këtë botë, duhet të shfrytëzohen e të përfshihen në disa prej ndërtimeve të Ahiretit ku të gjitha gjërat në të janë të gjalla e të vetëdijshme me gurët dhe me drurët e tyre, s***epse lënia e grimcave të Dynjasë në vetë dynjanë kur ajo të jetë shkatërruar ose t'i hedhësh ato në mosekzistencë, do të ishte çuarje dëm, prishje pa hesap. Dhe nga kjo e vërtetë zbulohet një maje prej një ligji madhështor, i cili është ***"Ligji i urtësisë"***.

Dhe meqenëse shumë rezultate, kuptime dhe fruta të kësaj bote dhe fletët e endura të akteve dhe veprave, dhe shpirtrat dhe trupat e atyre si xhindët dhe qëniet njerëzore të cilët janë ngarkuar me amanetin dërgohen tek tregu i Ahiretit, sigurisht është kërkesë e drejtësisë dhe e urtësisë se pas marrjes së plotësimit të tyre të veçantë në përputhje me kryerjen e detyrave të tyre, grimcat e tokës të cilat i shoqëruan dhe u shërbyen atyre frutave dhe kuptimeve, do të përfshihen në ndërtimin e Ahiretit. Domethënë, ato do të përfshihen në të së bashku me gërmadhat

---

[284] Kur'an, 14: 48
[285] Kur'an, 29: 64

e kësaj bote, e cila do të shkatërrohet, pasi ta kenë marrë dritën e jetës dhe t'i kenë shërbyer shumë herë dhe pasi të bëhen mjete për tesbihatet, për lavdërimet e krijesave të gjalla. Dhe nga kjo e vërtetë zbulohet një majë prej një ligji madhështor, i cili është: ***"Ligji i Drejtësisë"***.

Dhe meqenëse, ashtu si shpirti që është sundues mbi trupin, po kështu urdhrat që sjellin gjërat në ekzistencë, të cilat shkruhen nga Kaderi Hyjnor, janë sunduese mbi lëndën e pajetë. Lëndët e pajeta janë të afta të marrin një pozitë dhe një rregull sipas shkrimit jolëndor të Kaderit Hyjnor.

Për shembull, në të gjitha llojet e vezëve dhe të spermës dhe në shumëllojshmëritë e farërave dhe të bërthamave, lëndët marrin rangje të ndryshme dhe drita sipas urdhrave që i sjellin gjërat në ekzistencë, të cilat që të gjitha janë shkruar të ndryshme nga Kaderi Hyjnor, sepse ato lëndë të cilat janë të njëjtat për sa i përket substancës së tyre,[286] bëhen burimi i qënieve të panumërta të ndryshme. Ato arrijnë rangje e drita të cilat janë të gjitha të ndryshme. Atëherë, sigurisht, është kërkesa e njohjes gjithëpërfshirëse Hyjnore se në qoftë se një grimcë, ka qenë në mënyrë të përsëritur në shërbim të jetës dhe është përfshirë brenda tesbihateve, lavdërimeve Hyjnore që janë në jetë, urtësia e atyre kuptimeve do të shkruhet në ballin jolëndor të grimcës nga Pena e Kaderit Hyjnor, e cila nuk neglizhon absolutisht asgjë fare. Nga kjo e vërtetë zbulohet një maje prej një ligji madhështor, i cili është ***"Ligji i njohjes Gjithëpërfshirëse."*** **Atëherë duke u mbështetur në atë ç'ka u fol më lartë, grimcat [287] nuk janë pa qëllim.**

Për ta përmbledhur fjalën: Përtej majeve të dukshme të secilit prej shtatë ligjeve të lartpërmendura, domethënë, ***'Ligjit të Hyjnisë', 'Ligjit të Bujarisë','Ligjit të Bukurisë', 'Ligjit të Mëshirës', 'Ligjit të Urtësisë', 'Ligjit të Drejtësisë'*** dhe ***'Ligjit të Njohjes Gjithëpërfshirëse',*** dhe prej shumë ligjeve të tjera të mëdha, zbulohet dhe tregohet Emri më i Madh i All-llahut dhe shfaqja më e Madhe e Atij Emri më të Madh. Dhe nga ai manifestim mund të kuptohet se:

---

[286] Po, të gjitha ato lëndë përbëhen nga katër elemente: ***Ato përbëhen nga hidrogjeni, oksigjeni, azoti dhe karboni***. Në mënyrë qenësore -thelbësore- ato mund të konsiderohen të jenë të njëjta, ndryshimi ndërmjet tyre qëndron vetëm në shkrimin jolëndor të Kaderit Hyjnor.

[287] Kjo përgjigje shikon, shtatë fjalët ***"Meqenëse"***që u përmendën më lartë.

Ashtu si krijesat e tjera, transformimet e grimcave në këtë botë ndodhin me një balancë të ndjeshme të peshuara me njohje, sipas urdhrave të dhëna nga fuqia e Cila i sjell gjërat në ekzistencë, me limitet që ka vënë kaderi Hyjnor, për urtësi shumë të larta, por ato janë duke u përgatitur për të shkuar në një botë tjetër më të lartë.[288] Prandaj, trupat e qënieve të gjalla janë secili si një shkollë, një kazermë dhe një bujtinë për instruksionin e atyre grimcave udhëtuese. Dhe mund të deklarohet me siguri se kjo është kështu.

Përfundim: Ashtu siç është përmendur dhe provuar në Fjalën e Parë, të gjitha gjërat thonë ***"Bismil-lah"*** dhe kështu, ashtu si të gjitha qëniet, të gjitha grimcat dhe të gjitha grupet e grimcave dhe grumbullimet e veçanta të grimcave thonë ***"Bismil-lah"*** me gjuhën e gjendjes së tyre dhe lëvizin. Po! Çdo grimcë sipas kuptimit të Tre Pikave të mëparshme thotë me gjuhën e gjendjes së saj të natyrshme në fillim të lëvizjes së saj بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ ***"Bismil-lahirr-Rahmanir-Rahim"*** Domethënë**,** ***"Unë jam duke lëvizur me Emrin e All-llahut xh.sh., për hir të Tij, me lejen e Tij dhe nëpërmjet Fuqisë së Tij."*** Pastaj, ashtu si të gjitha krijesat, në përfundimin e lëvizjes së tyre, të gjitha grimcat dhe të gjitha grupet e grimcave thonë me gjuhën e gjendjeve të tyre: اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ***"El-hamdu lil-lahi Rabbil Alemin***", "*Gjithë lavdërimet e Falënderimet janë për Zotin e të gjithë botëve",* Kështu, çdo grimcë e shfaq veten e saj të jetë si një maje e një pene të vockël të fuqisë Hyjnore duke zbuluar qëndisjet e krijesave të punuara me mjeshtëri të cilat janë si poema lavdërimi. Në të vërtetë,

---

[288] Sepse, ashtu siç mund të vëzhgohet, drita e jetës ndizet e përhapet me shumicë e bujarisht në këtë botë të dendur e të ulët me një aktivitet që është tej mase i shtrirë, dhe një dritë e freskët e jetës ndriçohet gjerësisht, madje edhe një material i parëndësishëm, substanca të kalbura, dhe ato lëndë të dendura e të parëndësishme përpunohen dhe shkëlqejnë me dritën e jetës. Kjo tregon qartë se kjo botë e dendur dhe e pajetë po shkrihet nga Krijuesi dhe po shkëlqen e po bëhet më e bukur nëpërmjet lëvizjes së grimcave dhe dritës së jetës për hir të një bote tjetër më të hollë, më të lartë, më të pastër dhe të gjallë. Ato sikur po stolisen për të shkuar në një botë më të këndshme. Atëherë, ata të cilët nuk mund ta perceptojnë me mendjet e tyre të ngushta ringjalljen trupore të njerëzimit, në qoftë se do të shikonin me dritën e Kur'anit do të shihnin se një ***"Ligj i Vetekzistuesit të Vetëm"*** që duket qartë, do t'i ringjallë të gjitha grimcat, sikur ato të ishin një ushtri. Nëpërmjet atij ligji ekziston universi, dhe ai është aq gjithëpërfshirës, saqë shihet qartë se ai është në fuqi dhe sundon mbi krijimin.

secila nga ato e shfaq vetveten të jetë si maja e një gjilpëre duke u rrotulluar mbi krijesat, secila prej tyre është si pllaka e një gramafoni madhështor jolëndor Hyjnor me koka të panumërta; ato bëjnë që krijesat të recitojnë poema duke lavdëruar Mbështetësin e tyre, dhe duke i thurur lavde Zotit xh.sh..

دَعْوَيهُمْ فِيهَا سُبْحَانَكَ اللّٰهُمَّ وَتَحِيَّتُهُمْ فِيهَا سَلاَمٌ

وَ آخِرُ دَعْوَيهُمْ اَنِ الْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

سُبْحَانَكَ لاَ عِلْمَ لَنَا اِلاَّ مَا عَلَّمْتَنَا اِنَّكَ اَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

رَبَّنَا لاَ تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ اِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً اِنَّكَ اَنْتَ الْوَهَّابُ

اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ صَلاَةً تَكُونُ لَكَ رِضَاءً وَ لِحَقِّهِ اَدَاءً وَ

عَلَى آلِهِ وَ صَحْبِهِ وَ اِخْوَانِهِ وَ سَلِّمْ وَسَلِّمْنَا وَ سَلِّمْ دِينَنَا

آمِينَ يَا رَبَّ الْعَالَمِينَ

"Duaja (lutja) e tyre atje do të jetë: 'Lavdia të takon Ty o All-llah!' Dhe 'Selam' do të jenë përshëndetjet e tyre atje. Ndërsa duaja e tyre e fundit do të jetë: Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Zotin e të gjithë botëve."[289] *"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."*[290]

"Zoti ynë! Mos na i lër zemrat tona të shmangen nga e vërteta pasi Ti na ke udhëzuar, dhe na dhuro mëshirë nga mëshira Jote. Vërtetë Ti je Dhuruesi më i Madh."[291]

O Zot! Jepi bekime shkëlqesisë sonë Muhammedit që do të të kënaqin Ty dhe që të jetë një përmbushje e të vërtetës së tij, si dhe familjes së tij, shokëve të tij, vëllezërve të tij, dhe jepu atyre paqe. Dhe na mbro ne dhe mbroje fenë tonë. Amin. O Krijuesi i të gjitha botëve!

* * *

[289] Kur'an, 10: 10
[290] Kur'an, 2: 32
[291] Kur'an, 3: 8